

vijon nga nr. 3-4, 2016

6. Rishtarët e Provincës Kishtare të Arbënit dhe të Arqipeshkvisë së Shkupit në Kolegjin Ilirik të Loretos

Kjo rubrikë e fundit ngërthen si pjesë e dytë e studimit tonë listën e përzgjedhur të seminaristëve të Provincës Kishtare të Arbënisë si edhe të Arqipeshkvive të Tivarit dhe të Shkupit, që u pranuan në Kolegj gjatë viteve 1580 – 1860. Sistemimi i saj është bërë në përputhje me tri fazat e ndryshme që përjetoj historiku i këtij kolegj: I. 1580 – 1623 (§ 6.1.); II. 1624 – 1798 (§ 6.2); III. 1834 – 1860 (§ 6.3); e më tej, sidomos për fazën e dytë në varësi me burimet kryesore arkivore që kemi pasur në dispozicion. Në këto lista lexuesi i zellshëm dhe i interesuar do të marrë informacion mbi emrat e seminaristëve të regjistruar në kolegj, të dhënat e tyre themelore biografike, sikurse edhe mbarëvajtjen e tyre deri në përfundim (ose jo) të studimeve; ai do të mësojë sipas rastit edhe ndonjë detaj për do ngjarje të ndryshme që lidhen me jetën e njërit apo tjetrit seminarist në veçanti, meshat e para te celebruara prej tyre, karrierën klerikale, sikurse edhe ndeshtrasha të rastit: zullume, arrati, dënime, por edhe sëmundje, ndarje nga jeta etj., në fund të fundit gjithçka nga pak.

6.1. Faza e parë e kolegjit: vitet 1580 – 1623

Siç u vu në dukje më lart (§ 5.1), në fazën e parë të aktivitetit të Kolegjit Ilirik të Loretos në Loreto (1580 – 1593) dhe në Romë (1594 – 1623) nuk kemi në dispozicion regjistra vjetorë të nxënësve në kolegj, përpos ndonjë liste rastësore emrash, duke u mbështetur kështu kryesisht në burime dokumentare të shpërndara në disa arkiva historikë ose botime me karakter enciklopedik. Ndër emrat e rishtarëve me origjinë shqiptare vijnë në vështrim 5 syresh, pa mëtuar këtu aspak plotësinë dhe vërtetësinë absolute të informacionit:

1. <Ducas Armani> (= /Dukë Ermanji/) nga Shkodra: para vitit 1590 (§ 5.1.1)
2. <Petrus Budis/Bulis> (= /Pjetër Budi/): (1566 - 1644): rreth vitit 1586/7 (§ 5.1.2)
3. <Damiano Albanesi> nga <Gionama> (: shq. Gjonmi?): në vitin 1596 (§ 5.1.)

4. <Georgius/Gezzi Blanchus> = /Gjergj ~ Gjec Bardhi/: para vitit 1610 (§ 5.1.3.)
5. <Andrea Lopez> = /Ndre Lopësi/: para vitit 1610 (§ 5.1.4)
6. <Pietro Isij> = /Pjetër Izi/: para vitit 1610 (§ 5.1.4)
7. <Marco Albanesi>: në vitin 1618 (§ 5.1.4)

6.2 Faza e dytë e kolegjit: Vitet 1624 - 1798

Siç përmblohdhëm thukët më lart (§ 5.2), dy ndër burimet kryesore dokumentare që kemi në dispozicion e që bartin funksionin e dëshmitarit okular dallojnë qartë dy periudha të veçanta lidhur me identifikimin e rishtarëve kryesisht me origjinë shqiptare që vinin nga Provinca Kishtare e Arbënit, Arqipeshkëvia e Shkupit dhe një kohë edhe nga Kisha Metropolitane e Ohrit: a) 1624 - 1686/91 (ASSC: Antichi Regimi, tit 30-32 1r – 85v); dhe b) 1693 - 1798 (ASPF: SC Collegi vari, vol. 35 dhe 36). Funksion plotësues, por po aq domethënës për të dyja këto periudha luan burimi i tretë: c) *Liber Juramentum* (ARSI: Sig. Rom. 229), i cili për fatin tonë të brishtë nuk e mbulon gjithë atë hapësirë kohore që mëton faza e dytë e gjallesës së këtij kolegji. Të dhëna biografike shtesë mësojmë qoftë edhe me pikatore prej botimeve me karakter enciklopedik si p.sh. Farlati & Coleti (bl. VII dhe VIII). Në vijim po rendisim në mënyrë kronologjike të gjithë ata emra rishtarësh (kryesisht) me origjinë shqiptare që erdhën e u regjistruan në kolegji nga trevat e përmendura më lart.

6.2.1 Vitet 1624 - 1686 (/1691)

8. <Giorgio Neri> (=shq. <Gjergj Isij> [?]): nga Kruja; hyri pas gjase si organikë e Kolegjit Ilirik në programin mësimor të Kolegjit Klementin në Romë më 20 korrik 1622, por u transferua më 1624 në Loreto, kur u rihap ky kolegji. U largua për në dioqezën amë katër vjet më pas, bash më 1 gusht 1628 [1r = 71],¹ pasi ishte bërë më parë diakon më 18 tetor 1727 dhe shuguruar prift më 23 shtator 1628 [50r = 170]
9. <Stefano Gaspari> (= shq. /Shtjefën Gaspri/): prej Durrësi; hyri në Kolegjin Ilirik në Loreto më 1 shtator 1625. Betimin rezultoi ta ketë bërë në vitin 1628.² U transferua më 15 maj 1633 me vendim të Kongregacionit të Shenjtë në Kolegjin Urban në Romë për të

1 Në kllapa katrore janë dhënë krahas numrit të foljeve në rectus (r) dhe versus (v) të burimit arkivor (ASSC: Antichi Regimi, tit 30-32 1r – 85v) edhe korrespondencat me faqet përkatëse në punën e akribtë të Jurić & Korade. (1983)

2 ARSI Rom 229 2r: Për Shtjefën Gasparin sikurse edhe për disa rishtarë të tjerë në kolegji: Nicolaus Antivarinus, Nicolaus Soscius etj., shënohet vetëm viti i betimit (1628), pa datën dhe muajin përkatës.

studiuar aty teologji skolastike dhe morale. Është i pari ipeshkëv i Sapës që doli nga bankat e këtij kolegj. [1r = 71-2] Gjatë studimit në Loreto iu dhuruan katër urdhrat minorë prej Kardinal Roma-s në Recanati në dhjetor të vitit 1633. [51r = 171]

10. <Giovanni Cochino>: prej <Monte Nuovo-s> (= sr.-kr. /Novobrdo/) në Arqipeshkëvinë e Shkupit. Hyri në kolegj më 13 maj 1923 gjatë periudhës së tij romane (në Kolegjin Klementin), duke u bartur për në Loreto më 28 shtator 1628. U largua nga kolegj më 2 gusht 1629 për në vendlindje. [2v = 73]
11. <Francesco Bianchi> (= /Frang Bardhi/): prej Zadrime; hyri në Kolegjin Ilirik (si) nëndiakon më 22 korrik 1628, në moshën 22 vjeç, duke bërë betimin një vit më vonë, shi më 8 prill 1629.³ U transferua 15 maj 1633, bashkë me Shtjefën Gasprin (nr. 9) në Kolegjin Urban të Propaganda Fide-s në Romë me vendim të Kongregacionit të Shenjtë të Propagandës me studiuar aty teologji skolastike dhe morale. [3r = 74] Gjatë studimit në Loreto fitoi statusin e diakonit në dhjetor të vitit 1632 prej Kardinal Roma-s në Recanati. [50v = 171]
12. <Jacomo Isij> (= shq. /Jak Izi/): prej Lezhe; hyri në kolegj më 5 qershor 1629 në moshën 16 vjeç, duke zënë vendin që i ishte caktuar Dioqezës së Scardona-s. U largua më 15 prill 1635 për në atdhe për arsye të gjendjes së tij shëndetësore e me shpresë se, duke ndryshuar klimë, aty do të përmirësohej. [3v. = 74]
13. <Marco Giansi> (= /Mark Gjanshi/): prej dioqezës së Lisit; hyri në Kolegjin Ilirik të Loretos më 5 qershor 1629, në moshën 20 vjeç, në vendin e caktuar për Kishën e <Maccarebse-s> (?). [3v = 74] Në librin e betimeve mësojmë edhe atësinë dhe datën e betimit të tij: <24. Februari / Marcus Joannis Giansij: Diec. Lissien.>⁴ Më shumë se kaq nuk dimë gjë.
14. <Jacobus Petri> prej dioqezës së Lisit: emër, të cilin e ndeshim në këtë formë vetëm në librin e betimeve, i cili rezulton të ketë kryer betimin të njëjtën ditë me Mark Gjanshin. (nr. 13) Regjistrim më se i qartë në këtë libër,⁵ por që nuk e ndeshim në regjistrat e mirëfilltë të kolegjit.

3 ARSI Rom 229 3v.

4 ARSI Rom 229 3v.: Do vërejtur në këtë rast emërtimi latinisht i dioqezës: <Diëç[esi] Lissien[sis]>, i cili të kujton emërtimin e dikurshëm të Dioqezës së Lisit e jo atë të Lezhës (= <Alexiensis>).

5 ARSI Rom 229 3v.: <Jacobus Petri: Lissien.>. Një regjistrim i veçantë për <Jacomo Isij> mungon në këtë libër.

15. <Giorgio Vladagni> (= /Gjergj Vlladanji/): prej (Arqipeshkëvisë së) Tivarit; hyri në kolegji më 6 shtator 1630 në moshën 17 vjeç si nënshkruar i Portës së Lartë në vendin e caktuar për Arqipeshkëvinë e Shkupit, por pa dorëzuar në kohë letrën shoqëruese vendimmarrëse të ipeshkvit. U largua më 8 shtator 1637. [4r = 75] Më dt. 28 mars 1637 iu dhuruan katër urdhrat minorë prej Imz. Amico Panico, Ipeshkëvi i Recanati-t. [51v = 171] Arrin të ngjitet në karrierë deri në fronin e ipeshkvit të të Lezhës. [4r = 75]
16. <Andra Bogdani> (= /Ndre Bogdani/): prej fshatit <Gianani> (= Gjonaj ?) në Dioqezën e Prizrenit; hyri në kolegji më 6 gusht 1631 në moshë të pazakonshme, plot 24 vjeç e me vendim të posaçëm të Kongregacionit të Shenjtë të Propagande Fide-s, duke u pas shtuar mbi numrin e fiksuar për rishtarët atë vit. Kreu betimin më dt. 25 mars 1632.⁶ U largua me leje të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s më 10 shtator 1636. Ndreu u zgjodh më pas arqipeshkëvi i Kishës Metropolitane të Ohrit. [4v = 75] Detaje të tjera lidhur me mbarëvajtjen e studimeve në kolegji i mësojmë rreth 50 folje më pas; kështu: “Ndre Bogdani, shqiptar, mori më 22 dhjetor 1635 të gjithë urdhrat e vegjël (minorë) në Recanati prej Imz. Amico Panico, ipeshkëvi i Recanati-t dhe Loretos. I njëjti Ndre fitoi statusin e nëndiakonit prej të njëjtit imzot në të njëjtin qytet të Recanati-t më 27 dhjetor të të njëjtit vit 1635. I njëjti Ndre mori statusin e diakonit prej të njëjtit imzot në të njëjtin qytet më 30 dhjetor të të njëjtit vit 1635. Të njëjtit Ndre iu dhurua shugurimi i priftit prej të njëjtit imzot në Macerata më 20 janar 1636.” [51r = 171]⁷
17. <Paolo Bianchi> (= /Pal Bardhi/): shqiptar prej <Sardagnia> (sic! = /Sardës/) në Dioqezën e Sardës (= /Shurdhanit/ dhe) Sapës; hyri në kolegji në moshën 12-vjeçare më 11 maj 1632 me vendim të Kongregacionit të Shenjtë: pjesërisht me shpenzimet e këtij institucioni, pjesërisht me sosh të bursës Dataria e pjesërisht sosh të bursës së Kardinalit Sant Onofrio (= Kardinal Barberini-t)⁸, duke

6 ARSI Rom 229 4r: <[...] et 25 Martij Anni millesimi sexcen. triges. secundi (= 1632) | Andreas Joannis Bogdani, Diæces. Priseren.>

7 Teksti origjinal: “Andrea Bogdan Albanese alli 22. di Xbre 1635 prese tutti gli ordini minori in Recanati da Monsig[no]re Amico Panico Vescovo di Recanati, e Loreto. L'istesso Andrea prese il Subdiaconato dall'istesso Monsig[no]re nell'istessa Citta di Recanati alli 27. di Xbre dell'istesso anno 1635. L'istesso Andrea prese il Diaconato dall'istesso Monsig[no]re nell'istessa Citta adi 30 di Xbre dell'istesso anno 1635. L'istesso D. Andrea prese il Sacerdotio dall'istesso Monsig[no]re in Macerata adi 20 Gennaro 1636.”

8 Në ASSC Loreto: Tit XXX fasc. 2, fol. 1r: lexojmë edhe shënimin lidhur shpenzimet e

u pranuar mbi numrin e zakonshëm dhe falë ndërhyrjes së ipeshkvit të Sapës, ungjit të vet (= Imz. Frang Bardhit), i cili e pajisi edhe me dokumentacionin e nevojshëm. Betimin e kreu më dt. 21 tetor 1633. Dëshmia e betimit na mëson edhe atësinë e tij si i biri i Pjetrit: <[...] et die 21. Xbris Anni 1633 Paulus Petri Blanci diēc. Sapatēn.>⁹ Pas përfundimit të studimeve u lirua prej Kongregacionit më 27 gusht 1640, duke iu dorëzuar leja me shkrim prej rektorit të kolegjit. Arrin të bëhet dikur edhe Ipeshkëv i Sapës [4v = 75]

18. <Demetrio Bianchi> (= /Dhimitër Bardhi/): prej Zadrimë; hyri në kolegji më dt. 25 gusht 1635, duke zënë vendin e fiksuar për Tej-Drinin (= <citra Drinum>). Betimin e bëri një vit më pas, më dt. 28 shtator 1636,¹⁰ por s'e mbajti më gjatë se pesë vjet, sepse i la pendët kolegjit, duke ua mbathur nga sytë këmbët më 30 korrik 1641, kur jeste në Recanati. [6r = 77] Më shumë se kaq nuk kemi mundur të mësojmë dot gjë.
19. <Georgio Scura> (= /Gjergj Skurra/): prej Lezhe; hyri në kolegji më 1 dhjetor 1637, duke përfituar vendin e caktuar, por të pazënë për (Ipeshkëvinë e) Scardona-s. U largua pas shtatë vjetësh pa përfunduar studimet, më saktë thjesht i përzënë prej kolegjit zullumqar i pandreqshëm më 16 gusht 1644. [6r = 77]
20. <Giouanni Crisio> (= /Gjon Kryeziu/): shqiptar rreth të 15-ave, kur hyri në kolegji më 27 qershor 1640; jetonte atëbotë në Recanati, ku zuri aty vendin e Pal Bardhit. [7v = 79] Ky emër rimerret në regjistër disa folje më poshtë [12v = 85]. Aty mësojmë ndonjë të dhënë shtesë, ndër të tjera: “/Gjon Kryeziu/ shqiptar; nuk kishte mbushur ende të 16-at kur hyri në kolegji në vend të Pal Bardhit. Bëri edhe betimin më dt. 28 tetor 1640.¹¹ Studioi logjikë, por nuk ishte i prerë fare për këto lëndë, andaj u trajtua me program të veçantë: <Casi di Coscienza>. Si i tillë arriti të përfundonte studimet, madje edhe të shugurohej prift, duke u larguar nga kolegji më dt. 2 tetor 1649.”
21. <Paolo Marco Samarisco>: shqiptar prej Dioqezës së Shkodrës që paska hyrë në kolegji më 1 dhjetor 1637, duke zënë vendin e

ushqimit për të dhe Pal Bardhin (nr. 17), si vijon: “Per l’Alimenti di due Albanesi: Pavlo Bianchi et Andre Bogdan se riceuono dalla Congregazione de Propaganda Fide 4 volte l’anno scudi 36 al fine d’ogni trimestre ed al fine di nov[embre] di quest anno 1635 si devono per il trimestre futuro.”

9 ARSI Rom 229 4r.

10 ARSI Rom 229 5r: <[...] die 28 7bris 1636 | Demetrius Blanci, Dięc. sapatēn.>.

11 ARSI Rom 229 6r: <28. 8bris Anni 1640 | [...] Joannes Jacobi Crisij, Dięc. Sapatēn.>

paracaktuar për Dioqezën e Scardona-s. Nuk mësojmë gjë tjetër për të, përpos kumtit se: “U dëbua nga kolegji më 6 mars 1644” [7r = 79] Ndoshta kemi të bëjmë edhe në këtë rast me një shformëzim emri, bash të rishtarit shkodran <Joannes Paulus Marci> (= /Gjon Pal Marku/), të cilin e ndeshim si të tillë vetëm në librin e betimeve, ku regjistrohet së bashku me Gjon Kryeziun (shih më lart) më dt. 28 tetor 1640:¹² Rast tjetër i paqartë.

22. <Christoforo Cocomarich>: prej <Monte Nuovo> (= sr.-kr *Novobrd*) në Arqipeshkëvinë e Shkupit. Hyri në kolegji më dt. 26 shtator 1638 në moshën 13 vjeç, duke zënë vendin e mbetur bosh pas largimit të <Giouanni Cochino-s>. (nr. 10) Largohet për në dioqezën amë 10 vjet më pas, më 3 prill 1648, i shuguruar prift. [7v – 78], pasi kishte dalë mirë në kurset e filozofisë dhe në <Casi di coscienza>. [12r – 85]
23. <Giovanni Scanda>: shqiptar prej Lezhe; hyri në kolegji në fund të muajit mars 1638, në moshën 17 vjeç e me bursën përkatëse që i takonte sipas radhës ipeshkvit të asaj dioqeze, duke zënë kështu vendin e Mark Gjanshit prej qytetit të sipërpërmendur. (nr. 13) U largua nga kolegji pas tre vjetësh më 26 korrik 1641 me vendim të Kongregacionit të Shenjtë, meqë nuk ia thekte hiç në punë letrash dhe studimi [7v = 79-80], edhe pse në librin e betimeve rezultoi ta ketë kryer atë më 1 janar 1640.¹³
24. <Nicolò Curpeno> (= /Nikollë Kurbini/): shqiptar i Dioqezës së Krujës, pa mbushur ende moshën 19 vjeç; hyri në kolegji në Recanati më 25 korrik 1640, duke zënë një vend prej atyre që kishin mbetur vakante e sipas vendimit të Kongregacionit të Shenjtë do të ziheshin me vendim/dekret të veçantë dhe me shpenzimet e atij institucioni. Dekretimi pasoi, sapo u bë e njohur prej dioqezës që rishtari në fjalë i kishte marrë ndërkohë katër urdhrat minorë. Betimin e kreu më dt. 29 janar 1641.¹⁴ Veçse pas gjashtë vjetësh, më 25 gusht 1647, e dëbojnë nga kolegji për sjellje të pahijshme. Pavarësisht nga këto akuza, të nesërmen e asaj dite iu vunë në dispozicion 25 skuda thjesht me mbuluar shpenzimet e rrugës. [8v = 80]
Sa bindëse është arsyeja e regjistruar për dëbim? Fakt është që rasti /Kurbini/ rimerret edhe një herë në këtë regjistër [12v = 85], ku përpos të dhënave më lart mësojmë disa hollësi që e vënë në dyshim këtë shkak, ndër të tjera: “Ky [= Nikolla ynë] u dëbua nga Kolegji

12 ARSI Rom 229 6r: <28. 8bris Anni 1640 | Joannes Paulus Marci, Diëç. Scutari | Joannes Jacobi Crisij, Diëç. Sapaten.>

13 ARSI Rom 229 6r: <Die 1. Anni 1640 | Joannes Nicolai Scandë, Diëç. Lissien.>

14 ARSI Rom 229 6r: <29 Jan. 1641 | Nicolaus Joanis Curpani, Diëç. Croiensis>

Ilirik më 25 gusht 1647, për sjellje të pahijshme dhe mosbindje ndaj eprorit eminent përkatës. Veçse më 31 tetor 1657 Nikollë Kurbini vjen e na bëhet Arqipeshkëv i Durrësit, për më tepër këtu në Loreto na paska shpallur me be publike pafajësinë e tij, përkatësisht që gjithë ajo mesele paska pasur të bëjë thjesht me larje hesapesh e xhelozit të pashoqe, duke shtuar që, ndërsa po pengonte të tjerët për kryerjen e atij veprimi malum (?), shkuan dhe e prenë në besë bash eprorët e vet, duke e gjykuar kotsëkoti fajtor, anipse s'kishte kurrfarë faji në gjithë atë katrahurë [...]"¹⁵

25. <Marco Cabassi> (= /Mark Kabashi/): shqiptar prej qytetit të <Ansate> (?) që s'kishte mbushur ende moshën 19 vjeç. Erdhi në kolegji më 15 janar 1641 me vendim të Kongregacionit të Shenjtë, i cili shpenzonte për të vetëm 6 skuda në muaj, deri sa të hapej një vend i plotë, i parashikuar në kolegji. Megjithatë u largua më 13 qershor të po atij viti sepse nuk donte të bënte asesi betimin, për t'u veshur frat i Urdhrit [Françeskan] të Observantëve. [8r = 80]
26. <Martino di Lorenzo ~ Martinus Laurentius> (= /Martin Lari/ ?): shqiptar i Principatës (sic! – zonës) së Zadrimës; hyri në kolegji në moshën 13 vjeç më dt. 13 qershor 1641 me dekretim të bërë një muaj më parë, më dt. 13 maj, prej Kongregacionit të Shenjtë, i cili merrte përsipër edhe shpenzimet e rastit, derisa të lirohej në kolegji vendi që sipas bulës vendimmarrëse u takonte rishtarëve shqiptarë. Betimin rezulton ta ketë bërë më dt. 8 prill 1642.¹⁶ U largua nga kolegji më dt. 23 gusht 1650, pasi mbaroi studimet në <Casi di Coscienza> dhe u shugurua prift. [8r = 80¹⁷] Disa folje më poshtë [12v = 86] mësojmë diçka më shumë mbi Martinin tonë, ndër të tjera edhe dëshminë, se ai kishte studiuar: “[...] Casi di Coscienza.”¹⁸

15 Teksti original italisht: “[...] Questo fù scacciato dal Coll.º Illirico li 25. Agosto 1647. per le sue impertinenze, e per non hauer uoluto ubedir l'Em.ºº Comprotettore. Adi 31 Ottobre 1657 questo NICOLO CURPENI fù questo anno creato Arciuescouo di Durazzo, e qui in Loreto ha attestato con giuramento la sua innocenza quello tocca alla rottura delle gelosie: e dice che era ito per impedire gli altri nel qual atto fù colto, e giudicato colpeuole, ma era innocente, onde ha uoluto ciò aggiungere prima di che egli Arciuescouo fù qui in Coll.º per andare alla sua residenza.”

16 ARSI Rom 229 6r: <Martinus Laurentij Crisij>.

17 Jurić & Korade 1982 80 e regjistronjë si <Martino di Lorenzo Crisiu>.

18 Teksti original italisht: “Martino di Lorenzo Crisio d'anni 13. Albanese del principato di Zadrima uenne in Coll.º li 13. Giug. 1641. con Decreto fatto li 13. Mag. 1641. dalla Sacr. Cong.ºº che hà mantenuto à spese della med.ª Cong.ºº finche uachi un luogo della disposit.º della Bolla, che tocchi à gli Albanesi come apparisce nel med.º decreto, mandato dall'Em.ºº Protettore à Monsig.º Governatore. Parti 23. d'Agosto 1650 studiati Casi di Consienza.”

27. <Marco di Teodoro Crissio> (= /Mark Teodor Kryeziu/): shqiptar i qytetit (sic! – Dioqezës) së Sapës në Principatën (sic! – zonën) e Zadrimës. Ishte 19 vjeç kur erdhi në kolegji më dt. 13 qershor 1641 me urdhër të Sekretarit të Kongregacionit të Shenjtë, duke zënë aty vendin e mbetur vakant me rastin e largimit të Mark Kabashit. Këtë urdhër ia dorëzoi rektorit të Kolegjit ipeshkvi i Sapës, Imz. (Frang) Bardhi dora vetë. Guvernatorit të Kolegjit i bie të ketë marrë kështu në dorëzim Mark Kryeziun pikërisht atë ditë kur i la pendët kolegjit adashi kryeneç Mark Kabashi. (nr. 25) [8v – 80] Do folje më poshtë [13v = 87] mësojmë diçka më shumë edhe mbi Markun tonë, pas gjase të mbarë, ndër të tjera që: u shugurua prift më 21 dhjetor 1647, pasi kishte përfunduar studimet në filozofi dhe teologji skolastike e morale. U largua për në dioqezën amë më 3 maj 1648.¹⁹ Betimin rezulton ta ketë bërë më dt. 2 gusht 1641.²⁰

***²¹<Baldo Albanassi> (= shq. /Baldo Arbanasi/ ?): nga Zara (= <Zadar>, Kroaci) në fund të muajit mars 1638. Ai u dërgua në kolegji në moshën 18 vjeç prej Imz. Cappello-s, arqipeshkëv i Zarës, dhe mbërriti aty më dt. 14 korrik 1641. Për të pagoi fillimisht Kongregacioni i Shenjtë, deri më dt. 17 prill 1646, kur u lirua vendi i parashikuar për atë dioqezë. Ky nxënës u largua më 30 mars 1648, pasi ishte shuguruar prift do kohë më parë. Studioi me sukses filozofi dhe teologji skolastike. [9r 82] Betimin e kreu më dt. 2 maj 1642.²²

Emrin e plotë të këtij rishtari, pas gjase me rrënjë shqiptare den-baba-den: <Baldassar Albanasio> (= /Baldazar Arbanasi/ ?), e mësojmë në të njëjtin regjistër disa folje më poshtë [13r = 86-7], bash aty ku bëhet fjalë, përpos rezultateve të mira në studime, edhe se “[...] ka qenë një rishtar i censhëm e se është sjellë gjithmonë shumë mirë ndaj eprorëve. [...]”²³

19 [i panumëruar - B.D.] Teksti plotë original: “Marco Theodoro Crisio d’anni 19. Albanese della Città di Sappatense nel Principato di Zadrima uenne in Coll.º li 13. Giugno 1641. con ordine di Monsig.º Ingoli, che fusse costituito in luogo di MARCO CABASSI che doueua partire, e mantenuto in Coll.º à spese della Sacr. Cong.ºe quest’ ordine fù portato da Monsig.º BIANCHI Vescouo Sapatense essendo l’istesso giorno partito MARCO CABASSI per andare à farsi Frate. Poi stette in luogo di MARINELLI il qual partendo di Roma, l’Em.º Sig.º Card.º Palloto gl’impetrò di nuouo gli Alimenti dalla sacra Cong.ºe Fù fatto sacerdote 21 di Xbre 1647. hauendo studiato Filosofia e Teologia scolastica. Partì li 3. Maggio 1648.”

20 ARSI Rom 229 6r: <Marcus Theodori Crisij>

21 Rishtar, pas gjase më origjinë familjare shqiptare, i cili nuk është rrokur në numërimin e listës sonë, meqë nuk vjen prej hapësirës kompakte shqipfolëse.

22 ARSI Rom 229 6r: <Baldus Natalis Albanasij: 2 Mai 1642>

23 Teksti original italisht: “Baldassar Albanasio da Zara d’anni 18. uenne in Coll.º 14.

28. <Pietro Bogdano> (= shq. /Pjetër Bogdani/): nga Prizreni, i dërguar në Kolegjin Ilirik prej eminencës së tij, zotit Kardinal Pallotto (gubernator i Kongregacionit të Propaganda Fide-s) dhe i shoqëruar pas gjase prej arqipeshkvit të Ohrit më 20 mars 1648 në vendin e Christofaro Chocomerich prej Montenuovo-s [= *Novobrdo* – B.D.]. Pati hezitime, nëse atij i takonte vërtet ta zinte këtë vend, andaj edhe u ankuan hundë e buzë në adresë të eminencës në fjalë, i cili përgjigjet si vijon: “Para se të merrej në konsideratë Kisha [Metropolitane – B.D.] e Ohrit, emërimi i [vendit të studimit për Arqipeshkëvinë e – B.D.] Shkupit dhe Prizrenit – që janë në Provincën [administrative kishtare – B.D.] të Ohrit, në të cilën bëjnë pjesë *Mysia Superior* [= Misia e Epërme] dhe *Macedonia Secunda* – i takonte Arqipeshkvit të Tivarit [që ishte] edhe Primat i Serbisë. Por tani kjo [Kishë – B.D.] Metropolitane e ka bariun e vet dhe ka të drejtën për vende [studimi në kolegji – B.D.], që janë subjekte të juridiksionit të saj, andaj duhet të justifikohet emërimi i përmendur më lart për Pjetër Bogdanin. Hezitimi ishte që [Ipeshkvisë së] Prizrenit, atdheut të Pjetrit tonë, duhej t’i hapej një vend, bash kur Shtëpia e Shenjtë [në Loreto – B.D.] të mund të trajtonte me ushqim tetë subjekte të tjerë, të cilët [faktikisht] nuk i ushqen. [Bogdani – B.D.] ka sjellë kopjen e emërimit të Imz. Arqipeshkëv të Ohrit [= <Msgr. Raphael Leuacouich> – B.D.], i cili është depozituar në arkiv bashkë me letrën e dorëzanesit, eminencës së tij, z. Kardinal Pallotto. [Bogdani – B.D.] u nis për në atdhe, i kthyer nga Roma, ku u doktorua në Kolegjin [Urban – B.D.] të Propagandës me shumë përnderim ndaj tij. U soll [= në kolegjin Ilirik të Loretos - B.D.] gjithherë në mënyrë të përkryer; them se u nis më 17 maj 1651. [Arriti të fitonte postin] e Arqipeshkvit të Shkupit.” [14v = 89]
29. <Nicolò Vladagni> (= /Nikollë Vlladanji/): biri i Pjetër Vlladanjit, hyri në kolegji në fund të muajit shtator 1649, duke zënë vendin e Gjon Kryeziut. Erdhi me vendim të Ipeshkvit të Sapës, i cili dëshmonte në letrën e vet shoqëruese, të depozituar në arkiv, se Nikolla ka lindur prej prindërish të ndershëm katolikë, se kishte marrë ndërkohë sakramentin e Pagëzimit, dallohej për sjellje shembullore, ishte në moshën 16 vjeç dhe se do të mbulonte pas gjithë gjasash me shpenzimet e veta formimin fetar-intelektual në kolegji, pasi kishte sjellë fillimisht me vete 10 “pezze da oro” e

lugl. 1641. mandato da Monsig.^r Arciuesc. di Zara, paga per lui la sacr. Cong. de prop. Fide dopo resti in luogo di Cassio [= Cascio] ²⁶, che parti li 17. Aprile 1646. Parti li 30 Marzo 1648. fatto sacerdote li 21. Decem. 1647, hauendo studiato Filosofia et Teologia scolastica bene, et è stato giouane honorato, e portatosi sempre bene massime con li Superiori.”

pjesën tjetër do ta depozitonte në bankë, në mënyrë të tillë, që të mund të jetonte me përqindjet e fituara nga ky investim aspak i vogël.²⁴ Bëri betimin më 5 [sic! – 3²⁵] qershor 1650 dhe u largua nga kolegji më 10 qershor 1656. U shugurua pas gjase disa muaj më vonë prej ungjit të vet, Imz. Gjergj Vlladanjit, Ipeshkëv i Lezhës dhe u kthye më 23 maj 1657 rishtas në Loreto për të shoqëruar aty dy rishtarë të rinj. Nuk ka treguar ndonjë vullnet apo dëshirë të veçantë për të studiuar, madje në ndonjë rast ka qenë edhe fare mendjelehtë, sidomos në sjellje të dënueshme, “tenendo pratiche d’inamoramenti” si edhe në raste korrespondence letrash amatore [me tema] të ndaluara (= flirti/dashurie) në vitin 1653. Edhe pse duhej të sillej në përputhje me betimin e bërë, d.m.th. me shkuar menjëherë në atdhe, ai iku e na u soll rrotull nëpër Romë, duke hyrë nëpër ambiente familjesh fisnike në gusht 1658. Gjithsesi, në dhe të vet arrin të ngjitet deri në fronin e ipeshkvit të Lezhës. [15r = 90] Kumti i radhës që mësojmë në regjistër për Nikollën vjen pas 12 foljeve e tregon, se si ai ishte liruar nga kolegji prej Kardinal Pallotto-s dhe Kardinal Antonio-s, dhe se si më dt. 29 korrik 1658 një farefis i tyre nga Kotorri erdhi dhe e mori me vete atë së bashku me Marino Vlladanjin (nr. 33) për t’i shoqëruar për në atdhe, në shtëpinë prindërore.²⁶

30. <Giraldo Galata> (= /Gjerald Gallata/): 19 vjeçar nga Kruja; erdhi në kolegji më 14 shkurt 1650, duke zënë vendin e Nikollë Kurpenit (?). Këtë vend e zuri me vendim të Arqipeshkvit të Durrësit. U prononcua se dëshmia e pagëzimit dhe ajo e katër urdhrave minorë ishte paraqitur në Kongregacionin e Shenjtë në Romë pranë eminencës së tij, Kardinal Pallotto-s. E këto janë depozituar ndërkohë në arkivin e kolegjit.

Emri i këtij rishtari rimerret ndërmjetshëm (pasi është ndërkallur në të njëjtën faqe regjistrimi prej D. Francesco Segni-t në formë të asimiluar: <Girardo Galata>. Kështu: “[...] Gjeraldi ynë²⁷ u largua

24 Për Bursën Vlladanji shih më lart. (Pjesa I, § 4.2.)

25 Në librin e betimeve regjistrohet data 3 qershor, khs. ARSI Rom 229 7r: <Nicolaus Vladagni : 3. Junij 1650>

26 Teksti origjinal: “Nel medesimo giorno [? 30.07.1658 – B.D.] il sudd.º restò al Conuitto del Collegio fino ad altra risoluzione NICOLÒ VLADAGNI che ha dato per due mesate scudi dieci agli il luglio del med.º anno e poi per tre altri mesi come a suo luogo e notato. Fù escluso prima dal S.º Card. Pallotto poi da S.º Card. Antonio. Questo con Marino Vladagni essendo venuto un certo Padrone Mussacchia da Cattaro interessato, e come dice, parente di detto Marino e Nicolò si offerse a ricondurli al paese e li furono consegnati li 29 luglio 1658.” [27v = 103]

27 Emri i këtij rishtari rimerret ndërmjetshëm (pasi është ndërkallur në të njëjtën faqe regjistrimi i D. Francesco Segni) në formë të asimiluar: <Girardo Galata>.

nga kolegj i shuguruar prift, pasi kishte përfunduar programin e veçantë “Casi di Coscienza” më 31 mars 1656, duke u dalluar aty për sjellje dhe rezultate studimi më se të kënaqshme. Qëndroi do kohë në Romë me lejen e Kardinal Pallotto-s dhe u kthye më pas në kolegj më 23 qershor të po atij viti. Më pas u konsakrua Arqipeshkëv i Durrësit, dhe iu bë nderimi përkatës, duke vendosur në ambientet e kolegjit (në Portaria) një portret i tij. [19r = 94] Në një tjetër vend të të njëjtit regjistër [53v – 174] mësojmë se ceremoniali i shugurimit u zhvillua në Recanati më 11 mars 1656 prej Imz. Ipeshkëv Panico-s, i cili i kishte dhuruar më parë edhe titujt e nëndiakonit (13.03.1655) dhe të diakonit (18.09.1656)

31. <Girolamo Cocomarich> prej <Monte Nuovo-s> (= sr.-kr. *Novobrd*) në Arqipeshkëvinë e Shkupit [24v – 99]
32. <Nicolò Neri> (= <Nikollë Izi >?): shqiptar;²⁸ vuri këmbë në kolegj më dt. 16 qershor 1655, fillimisht si konviktor, në vendin e mbetur vakant për dioqezën e Bosnjës e me urdhër të Eminencës së tij, Kardinal Antonio-s. Më dt. 25 korrik u nis për në Venecia tek i ati, me lejë të Guvernatorit të kolegjit e për t’u kthyer rishtas në kolegj para fundit të tetorit të po atij viti. U kthye më 27 tetor. Më datë 25 nëntor bëri betimin.²⁹ U lirua nga kolegj pas tre vjet studimi filozofi, bash në qershor 1658, me motivacionin e një rishtari rrëmujaxhi e të pasjellshëm. [25r = 100]
33. <Marino Vladagni> (= /Marin Vlladanji/): u pranua në kolegj më dt. 25 maj 1657, i dërguar prej ipeshkëvit të Shkodrës, Imz. Pjetër Bogdanit. Në dosjen e tij ishin përfshirë dëshmia e pagëzimit dhe ajo e urdhrave minorë. Natën e 10 shkurtit 1658, duke dhënë edhe më parë shenja lajthitjeje “per hauere predominio di tetra malinconia”, aty rreth orës 9, shkoi e na u hodh vetë nga dritarja në rrugë, i nxitur prej “uehementi apprehensionioni e uane fantazie”. E sollën në banesë më njëren këmbë të thyer e tjetrën të dëmtuar keq. U kurua nga kirurgu i Shtëpisë së Shenjtë dhe qysh prej asaj dite iu shërbye në shtrat deri më dt. 29 korrik. U njoftuan edhe prindërit sikurse edhe Àt Nikollë Vlladanji (nr. 29) që jسته gjithsesi në Romë, por askush s’u kujtua të vinte e ta merrte. Nuk bëri dot as betimin, se jo vetëm nuk ishte në gjendje të mirë fizike e mendore, por ishte edhe fare i paaftë për të studiuar. Vendi i tij mbeti vakant prej 30 korrikut 1658 deri më 3 janar 1659. [27r = 102]
Siç përmendëm edhe më lart (shih <Nicolò Vladagni> më dt. 29

28 Nuk jepet asnjë e dhënë mbi dioqezën nga vinte. Kumti mbi takimin me të atin në Venecia nxit dyshimin se mos kemi të bëjmë me një familje shqiptare në atë qytet.

29 ARSI Rom 229 9v: <Nicolaus Nerius 25 9bris 1655>

korrik 1658 Marinin së bashku më Nikollë Vlladanjin erdhi e i mori për t'i shoqëruar për në vendlindje një farefis i tyre, një farë <Mussacchia> nga Kotorri. [27v = 103]

34. <Giorgio Cucca> (= /Gjergj Kuka/): u paraqit në kolegji më dt. 23.10.1658 për të zënë vendin e mbetur vakant për Dioqezën e Lezhës. Ishte i ri 20-vjeçar, i lindur në Krujë, i ardhur në Loreto me rekomandim të sekretarit të Kongregacionit të Shenjtë, ku qëndroi për rreth 10 muaj. Nuk kishte formim paraprak e s'kishte paraqitur asnjë dëshmi shkollimi, madje as dihet nëse kishte mundur të mësojë dikur në atdhe të shkruajë e të lexojë, lëre pastaj të dallojë emrat nga foljet. Po sendërtohej kështu gjithnjë e më shumë dyshimi, nëse ky çunak do të arrinte të përfitonte vërtet diçka në kolegji. Ishte i paaftë e për më tepër shumë agresiv. U dëbua nga kolegji më 25 korrik 1660 pasi kaloi do muaj në izolim të plotë, meqë kishte plagosur pas gjase rëndë një ruajtës të rendit që erdhi në kolegji për të ekzekutuar vendimin e guvernatorit e për ta larguar nga kolegji si të paaftë, përkatësisht për të mos i dhënë të drejtën për kryerjen e betimit. Ishte kjo arsyeja që u dërgua fillimisht në Romë në Kongregacionin e Shenjtë, ku gjeti strehë në burg për nja dhjetë muaj. [32r = 104-5]³⁰
35. <Giorgio Tullich/Tolich> (= /Gjergj Tuliq/Toliq/ ?³¹): prej Prizreni; u regjistrua në kolegji më dt. 4 janar 1659, duke zënë vendin e parashikuar për dioqezat shqiptare të Tej-Drinit. Për këtë rast gëzoi ndërhyrjen e fuqishme të Pjetër Bogdanit, atëbotë Ipeshkëv i Shkodrës. Nuk kishte formim paraprak, andaj filloi me përgatitjen e duhur në lëndët e gramatikës, edhe pse njihte katër gjuhë. Gjergjit iu krijua mundësia e një vendi studimi në kolegji, pasi Marin Vlladanjit iu desh të largohej për paaftësi mendore dhe mungesë shëndeti. Më dt. 4 [sic! – 2³²] korrik 1659 Gjergji bëri betimin dhe më 23 qershor 1664³³ u nis për në Prizren, në dhe të vet, i thirrur prej ipeshkvit të Shkupit, Imz. Andrea Bogdanit. Në kolegji mori katër urdhrat minorë, studioi gramatikë, vetëm dy vjet filozofi të pambaruar dhe gjysmën e “Casi di Coscienza”. Ishte djalosh inteligjent, por i gatuar së prapthi. I turbullt në gjykime dhe gjithmonë tinëzar si njeri. [33r = 156]

30 Shih edhe ASPF SOCG 372 37r: <Giorgio Cucca da Croia ...>

31 Për vendin e tij në kulturën e shkrimit shqip: “Letra e Pleqve të Gashit” (1689), shih Bartl & Camaj 1967.

32 Në librin e betimeve regjistrohet data 2 korrik, khs. ARSI Rom 229 9v: <Georgius Tullich 2. Julij 1659>

33 ASPF SOCG 372 123v: si datë largimi për në atdhe shënohet <30 8bric 1664> (= 30.10.1664)

36. <Vincenzo Mattevich>: prej Arqipeshkëvisë së Shkupit. Regjistrohët në kolegji më 8 korrik 1661, duke zënë vendin e <Girolamo Cuccumarich-it>. Kishte ardhur në fakt qysh në tetor 1660, por meqë nuk kishte me vete dëshminë e pagëzimit, që vërtetonte legjitimitetin e tij katolik den-baba-den; iu desh pra të priste deri atë ditë, kur i mbërriti dëshmia nga Raguza. Betimin e kreu më dt. 8 janar 1662, si i pari me tekstin e ri të miratuar në bulën e Papë Aleksandrit VII. U largua për në vendlindje më dt. 23 qershor 1664, i thirrur prej arqipeshkvit të vet, Imz. Ndre Bogdanit. Studioi pak logjikë dhe “Casi di Coscienza” Djalë për së mbari, por i mirë më shumë për të tjerët, andaj edhe nuk arriti të përfitonte atë që pritej prej tij. [37v – 159]
37. <Tomaso Rapsanouch>: prej Letnice në Kosovë. Hyn në kolegji më 1 janar 1665 në moshën 14 vjeç, i dërguar prej Imz. Ndre Bogdanit për të zënë vendin e <Vincenzo Mattevich>. Por pati probleme në pranim, se erdhi me gjashtë muaj vonesë. Nuk e njihte në fillim italishten, por dinte mirë turqisht dhe sllavisht. Më 5 korrik 1665 bën betimin dhe më 3 shtator 1667 kaloi në kursin e filozofisë e tre vjet më vonë studioi teologji skolastike dhe morale. Më 20 dhjetor 1670 fiton statusin e nëndiakonit dhe largohet më pas për në dioqezë më 26 prill 1672. Ishte djalë i zoti, veçse në kursin e fundit u desh të mësonte vetë si s’kishte komilitonë të tjerë, andaj nuk dha as provime. [44v = 165-6]
38. <Pietro Valmi> (= /Pjetër Valmi/): prej <Busyerpini> = *Buzgjarpëni* (?) në Dioqezën e Sapës. U dorëzua në kolegji më dt. 06.12.1665 prej ipeshkvit të asaj dioqeze, Imz. Simon Sumës. Ishte në moshën 17 vjeç e nuk dinte gjuhë (= italishte), madje as të lexonte, edhe pse e kishte marrë në vendlindje tonsurën³⁴. Bëri betimin më dt. 13 qershor 1666.³⁵ Më dt. 19 shtator 1671 mori katër urdhrat minorë, më dt. 24 shtator 1672 arriti nivelin e nëndiakonit. Më 4 shkurt 1673 u largua për në atdhe, pasi kishte përfunduar kurset e gramatikës dhe “Casi di Coscienza” me vlerësime mesatare, meqë edhe intelekti dhe aftësitë e tij linin vërtet për të dëshiruar. Por u soll në mënyrë të lëvdueshme. [48v = 169]
39. <Demetrio Isio> (= /Dhimitër Izi/): 15-vjeçar prej Lezhe. U dorëzua në kolegji më 6 dhjetor 1665 prej Ipeshkvit të kësaj Dioqeze, Imz. Gjergj Vlladanjit me zënë aty vendin e parashikuar për bursën e Këtej-Drinit (= *ultra Drinum*) Nuk dispononte tonsurën e parë, as njihte gjuhë dhe as dinte të lexonte. Bëri betimin më dt. 13 qershor

34 Qethja e flokëve si ceremonial i caktuar në formimin meshtarak.

35 ARSI Rom 229 12v.

1666. Më 19 shtator 1671 mori katër urdhrat minorë.³⁶ Natën e 20 nëntorit 1671 ia mbathi nga sytë këmbët nga kolegji. Meqë u bë zallamahi e madhe, u shpall gjithkund në qendrat përreth si Ancona, Sinigallia etj. kërkimi i tij, por pa qullosur dot gjë. Edhe ato gjashtë vjet që qëndroi në kolegji, u bë ç'është e mundur të kthehej për së mbari, por çdo përpjekje shkoi kot. Nuk ndryshoi asgjë për mirë në sjelljen e tij të keqe, gjykimin e papërgjegjshëm dhe shkallën e dobët të intelektit. Njeri për nga natyra i vranët dhe kokëzdrukth.

40. <Pietro Caragich> nga Monte Nuovo (= *Novobrd*o – B.D.), i dërguar në kolegji prej Imz. Ndre Bogdanit, arqipeshkëv i Shkupit. Hyn në kolegji më 4 gusht 1666 në moshën 17 vjeç e gjysmë e pasi kishte kaluar shumë peripeci gjatë rrugës. Njohës i turqishtes dhe sllavishtes. Në atdhe bën karrierë duke u ngjitur deri në fronin e arqipeshkvit të Shkupit. [57r = 177-8]

41. <Giovanni Bogdani> (= /Gjon Bogdani/): nipi i ipeshkvit të Shkodrës, Imz. Pjetër Bogdanit. U paraqit në kolegji më dt. 28 prill 1671, i dërguar prej axhës së vet, Imz. Andrea Bogdanit, Arqipeshkëv i Shkupit, duke zënë aty vendin e Tomaso Rapsasanouich-it (nr. 37). Iu desh gjithsesi të qëndronte do kohë në konvikt, meqë Tomaso nuk u largua menjëherë nga kolegji. Kështu, u regjistrua si rishtar në kolegji më vonë, shi më dt. 1 korrik 1672. Bëri betimin më dt. 2 korrik 1673.³⁷ Më dt. 3 shtator 1676 e mbylli me sukses studimin e filozofisë, duke kaluar në klasën e letrave humane. Më 5 mars 1678 mori katër urdhrat minorë prej Kardinal Crescentio-s, ipeshkëv i Loretos, në ceremoninë e ordinationit të zhvilluar në Kishën e Shtëpisë së Shenjtë. Më 22 maj 1679, ditën e Rrëshajave, iu dhurua statusi i nëndiakonit në qytetin e Ossimo-s, më dt. 23 ai i diakonit dhe më dt. 27 të po atij muaji u shugurua prift prej Kardinal Bichi-t dora vetë. Para se të lexonte meshën e parë, u përgatit disa ditë me radhë, duke bërë edhe tetë ditë të tjera ushtrime spirituale. Mesha e parë u zhvillua në Kapelën e Shtëpisë së Shenjtë e pas saj u sajua edhe një party e vogël meshtarake në ambientet e Sakristisë së Thesarit. Më dt. 20 korrik 1679 u nis për në atdhe me lejen e Kardinal Altieri-t për t'u dhënë në shërbim të nevojave të të ungit. Përveç letrave humane dhe filozofisë, studioi një vit edhe teologji skolastike dhe morale me rezultate të mira. Ishte gjithherë i rregullt e me sjellje shembullore dhe i aftë me shërbyer pa të meta në punët

36 Shënuar në fol 55v = 176

37 ARSI Rom 229 14v: <Jo.es Bogdanus 2 Julij 1673> Asistentë në betim ishin <Petrus Valmi et Petrus Jacobi>.

baritore. [65v = 184]³⁸

42. <Giovanni Giocouich>: rishtar i dërguar edhe ky prej Ndre Bogdanit në Arqipeshkëvinë e Shkupit. Hyri në kolegji më 6 janar 1673 në moshën 17 vjeç e gjysmë por pa njohuri të italishtes dhe gramatikës (latine). Nxënës me probleme të mëdha në sjellje, sepse nuk i bënte syri tërr për të fyer e kërcënuar këdo, madje edhe trupin mësimor. Andaj aty nga mesi i vitit 1677 nuk ia bënë të gjatë dhe i dhanë duart, duke i futur disa scuda në xhep për të marrë anijen e parë në Ancona në drejtim të vendlindjes. Mirpo edhe këtu nuk i zuri shpirti rehat; në vend që të shkonte në port mori rrugët për në Romë, ku u drejtua pa një e pa dy drejt e te kardinali guvernator i Kongregacionit të Shenjtë, të cilit iu përgjërua me aman e me derman, se ishte penduar për gjithë ato turpe e premtoi se do të bënte kthesë. Pas disa hezitimesh i dhanë edhe një shans të fundit që të përfundonte studimet. Dhe vërtet ashtu ndodhi. Studioi më pas teologji skolastike dhe morale, edhe pse nuk shkëlqeu. U largua më dt 26 korrik, pasi u shugurua prift. [69v-70r = 188-9]
43. <Giovanni Tiscovich>: prej Janjeve në Arqipeshkëvinë e Shkupit dhe nip i arqipeshkëvit, Imz. Ndre Bogdanit. Pati fat se hyri në kolegji me bursën e parashikuar për Perastin, sepse ipeshkvi i atyshëm nuk solli dot kënd atë vit, më 1677. Ndenji dy vjet në konvikt, sa mësoi bazat elementare. Betimin e bëri më dt. 15 janar 1679. Eci mirë në studime dhe në ngjitjen e shkallëve klerikale. Kështu më 28 tetor 1682 mori katër urdhrat minorë, më 1 nëntor 1682 edhe subdiakonatin, ndërsa më 7 mars 1683 fitoi statusin e diakonit. Më dt. 13 të atij muaji u shugurua prift prej Kardinal Gualtieri-t në Fermo dhe më 20 korrik u nis për në atdhe. [78r = 195]
44. <Antonio Pavlovich>: i dërguar në kolegji më 11 tetor 1680 në moshën 15 vjeç prej Arqipeshkëvit të Shkupit, Imz. Pjetër Bogdanit. Më 1 maj 1681 bëri betimin, veçse nuk zgjati shumë: më 30 nëntor 1683 lirohet nga kolegji për sjellje të egër dhe me rrezik për të tjerët. Një herë nuk i mjaftuan vetëm kërcënimet që u bënte zakonisht komilitonëve, por goditi me gur në kokë njërin prej tyre, duke e plagosur rëndë e lënë në vend pa ndjenja. Përpos sjellejeve të pahijshme, nuk ishte i prerë fare edhe në punë mësimi e shkolle. [82r = 198]
45. <Pietro Zumi> (= /Pjetër Zymi/ ?): prej <Zarusco> e Dioqezës së Durrësit; i dërguar në kolegji me bursë për dioqezat e Këtej-Drinit. Hyri në kolegji më dt. 11 korrik 1683 në moshën 16 vjeç. Kishte

38 Informacion i hollësishtëm dhe tejet admirues fol. 294 në të njëjtin vëllim (ASPF SC Collegi vari 35).

marrë ndërkohë katër urdhrat minorë dhe më 30 janar 1684 bëri betimin.³⁹ Mbaroi kurset e teologjisë e të filozofisë në korrik të vitit 1690. Për shkak të gjendjes së rëndë së luftës që sundonte në vendlindje, Kongregacioni i Shenjtë e lejoi të qëndronte edhe një vit më shumë, deri më dt. 28 korrik 1691. U shugurua prift, edhe pse me aftësi që linin për të dëshiruar, por që i kompensonte me sjelljen e vet shembullore. [85v = 199-200]

46. <Nicolo Busich>: prej <Liesina>⁴⁰ (= shq. /Lisna/ ?) i dërguar më 16 shkurt 1685 në moshën 19 vjeç me bursën e Tej-Drinit prej Domenico Bubich (~ <Babich>), ipeshkëv i Shkodrës, si edhe me konfirmim të guvernatorit të Loretos. Bëri betimin po atë vit, më 15 gusht. U largua më 1690 duke kryer shpejt e mirë të gjitha detyrimet në kolegji. Ishte nxënës modest dhe i zoti. [89v =202]

6.2.2. Vitet 1693 - 1798⁴¹

47. <Antonius Vladagnius> (= /Ndue Vlladanji/): shqiptar⁴² prej Lezhe (sic! - Shkodre⁴³) në Shqipëri; hyri në kolegji në moshën 14 vjeç dhe

39 ARSI Rom 229 17v.

40 Vështirësi në identifikimin me siguri të plotë të këtij toponimi, gjë që mund ta lëkundë dikur disi edhe origjinën e këtij rishtari. Gjithsesi një argument pozitiv për vendlindjen e tij në Dioqezën e Shkodrës mundëson qoftë bursa e studimit, ashtu edhe ipeshkvi i Shkodrës Domenico Bubich dora vetë, i cili hyri dorëzanë për të. Barazimin me toponimin e sotëm Lisna (në veriperëndim të Shkodres) e lejon edhe forma e dikurshme e këtij ngulimi <Lissina> si pjesë e Dioqezës së Shkodrës në relacionin e mëvonshëm të Vincenz Zmajević më 1702 në vegjilje të Kuvendit të Arbënit (Mërçinjë 1703: Shih Bartl 1979 35, 149). Në këtë rast varianti <Liesina> rezulton të jetë lexim e shkrim i gabuar për *<Lissina>.

41 Regjistrat e depozituar në ASPF fillojnë me vitin 1693, ndërkohë që nxënësi i fundit i përfshirë në fondet e ASSC (§ 5.2.1.) rezulton të jetë regjistruar në vitin 1686. Ndër rishtarët e dioqezave shqiptare, të fundit nxënës të regjistruar në këtë fond janë Pjetër Zymi (nr. 45) dhe <Nicolo Busich> (nr. 46) në vitet 1684 dhe 1685. Pra kemi një zbrazësi kohore ndërmjet viteve 1686 - 1693, për të cilën kemi vështirësi në identifikimin pak a shumë me saktësi të rishtarëve që u regjistruan dhe/ose përfunduan studimet e tyre në këtë periudhë. Zbrazësi kohore të kësaj natyre shfaqen herë pas here edhe në këtë periudhë të dytë (1693 - 1798). Boshllëkun më të madh në regjistrat vjetorë e kemi ndërmjet viteve 1704 - 1713. Mungojnë gjithashtu edhe regjistrat e këtyre viteve: 1715, 1716, 1718, 1720, 1724 - 1729, 1731, 1743, 1744, 1747, 1748, 1774, 1781, 1782 dhe 1788.

Vërejtje: Në tekstin tonë citohet rregullisht për çdo zë të veçantë vendi në burimin arkivor kryesor të kësaj periudhe, që është ASPF: SC Collegi vari, vol. 35 dhe/ose 36 me shifrat e folieve përkatëse. Burime dhe literaturë shtesë do të vendosen në fusnota, në mënyrë që të mos ngarkohet më shumë vetë teksti i rrjedhshëm.

42 Në këtë regjistër shënohet në rubrikë të vecantë gjuha e nënës (= <lingua>), një rubrikë kjo që mbyllet pas vitit 1695.

43 Vendlindja e tij, Shkodra, shënohet prej vitit të tretë, më parë regjistrohet Lezha si e tillë.

studioi aty fillimisht tre vjet (1693-1695) lëndën e gramatikës, më 1696 lëndët humane, ndërsa më 1697 filloi të studionte retorikë, të cilën e vijoi edhe vitin e pestë (1698); më pas studioi tre vjet (1699-1702) me radhë filozofi. [35 403r, 408r, 426r, 432r, 440r, 445r] Betimin rezulton ta ketë bërë më 7 qershor 1695.⁴⁴

48. <Joanes Ivanovich *seu* Princich>: prej Prishtine; hyri në kolegji në moshën 19 vjeç në vitin 1701, ku studioi tre vjet lëndën e gramatikës (1701-1703). [35 484r, 502r] Më shumë se kaq nuk mësojmë dot gjë.
49. <Marcus Beluchi> (= /Mark Belushi/ ?): prej Shestani; hyri në kolegji në vitin 1703 në moshën 14 vjeç e gjysmë, ku filloi të studionte në lëndën e gramatikës. [35 502r] Më shumë se kaq nuk mësojmë dot gjë.
50. <Marcus Trum(p)si> (= /Mark Trum(p)shi/): prej Arqipeshkëvisë së Tivarit; pas gjase ka hyrë në kolegji në vitin 1706, meqë është i regjistruar në vitin 1714 si i ri 21-vjeçar që studionte në kolegji në vitin e tetë lëndën e teologjisë. [35 610r] Betimin rezulton ta ketë bërë më dt. 22 maj 1707.⁴⁵
51. <Marcus Negri> (= /Mark Izi/ ?): prej Mërqinje në Dioqezën e Lezhës; pas gjase ka hyrë në kolegji në vitin 1708, meqë është i regjistruar në vitin 1714 si i ri 23-vjeçar që studionte në kolegji në vitin e gjashtë lëndët e teologjisë. [35 610r] Betimin rezulton ta ketë bërë më 22 nëntor 1708.⁴⁶
52. <Georgius Zacharias> (= /Gjergj Zaharia/): prej Dioqezës së Sapës; pas gjase ka hyrë në kolegji në vitin 1709, meqë është i regjistruar në vitin 1714 si nxënës 21-vjeçar që studionte aty në vitin e pestë lëndën e retorikës [35 610r], po ashtu edhe në vitin 1717. [35 620r] Betimin e kreu më dt. 22 nëntor 1708.⁴⁷
53. <Petrus Battuchi> (= /Pjetër Bytyçi/): prej Zyri (= <Sumbi>) pranë Prizrenit në Arqipeshkëvinë e Shkupit; pas gjase, ka hyrë në kolegji në vitin 1712, meqë rezulton të jetë i regjistruar vitin 1714 si i ri 17-vjeçar që studionte në vitin e dytë lëndën e teologjisë. [35 610r], po ashtu më 1717 [35 620r] dhe teologji në vitet 1719 dhe 1721 [35 648r; 657r]⁴⁸

44 ARSI Rom 229 18v.

45 ARSI Rom 229 20v.

46 ARSI Rom 229 21r.

47 ARSI Rom 229 21r.

48 Shih edhe ARSI Rom 229 21v: Në betimin e tij kanë qenë të pranishëm dhe firmosur si

54. <Simon Pelessa> (= /Simon Peleshi/): prej Dioqezës së Sapës; pas gjase ka hyrë në kolegji në vitin 1715, meqë është i regjistruar në vitin 1717 si i ri 17-vjeçar që studionte në vitin e tretë lëndën e gramatikës [35 620r], po ashtu edhe në vitin 1719, ndërsa në vitin e shatë, më 1721 lëndët e filozofisë. [35 657r]⁴⁹
55. <Petrus Sacci> (= /Pjetër Saçi/): prej Shkodre e me bursë të Tejdritit; pas gjase ka hyrë në kolegji në vitin 1718, meqë është i regjistruar në vitin 1721 si i ri 16-vjeçar që studionte në vitin e tretë lëndën e gramatikës [35 657r], po ashtu edhe në vitin 1722 [35 661r]. Nuk e hasim më këtë emër në regjistrin e vitit 1723 [35 674r] Pjetri kreu betimin më 29 prill 1719 në asistencën e Pjetër Bytyçit dhe Simon Peleshit.⁵⁰
56. <Jannes Niccolouisch> (= /Gjon P. Nikollë Kazazi/): prej Gjakove me bursë shtesë (= <supra numerarum>) për Arqipeshkëvinë e Shkupit; hyri në kolegji në vitin 1721, kur ishte në moshën 16 vjeç, pasi u transferua prej kolegjit të Fermos, ku qëndroi vetëm ndonjë muaj.⁵¹ Betimin e kreu pas gjase menjëherë pas ardhjes së tij në Loreto, bash më 27 tetor 1721, ku asistuan si dëshmitarë okularë Pjetër Bytyçi dhe Simon Peleshi.⁵² Në Loreto studioi vitin e parë gramatikë [35 657r], në të dytin (1622) mësojmë të ketë studiuar retorikë [661r] dhe të tretin (1723) të ketë filluar me lëndën e filozofisë. [35 674r] Më tej s'mësojmë gjë se informacioni dokumentar ndërpritet deri në vitin 1729.
57. <Nicolaus Diluessi> (= /Nikollë Delvesi/): prej Dioqezës së Sapës. Regjistri i vitit 1722 na mëson që Nikolla ynë të ketë hyrë në kolegji me bursën e Këtej-Drinit po atë vit në moshën 16 vjeç, kur filloi, siç pritej, të studionte gramatikë [35 661v], me të cilën vazhdoi edhe vitin e dytë, më 1723 [35 764r]. Më tej s'mësojmë gjë se informacioni ndërpritet deri në vitin 1729.
58. <Paulus Campsi> (= /Pal Kampsii/): prej Shkodre, duke zënë vendin e caktuar për Arqipeshkëvinë e Shkupit. Hyri në kolegji në vitin 1722, kur ishte në moshën 13 vjeç e mësoi dy vjet me radhë gramatikë. [35 661v, 674r] Betimin e ka kryer pas gjase më 27 janar

dëshmitarë okularë <Marcus Negri & Georgius Zaccaria>.

49 Shih edhe ARSI Rom 229 21v: Në betimin e tij kanë qenë të pranishëm si dëshmitarë <Marcus Negri & Georgius Zaccaria>

50 ARSI Rom 229 22r.

51 Për periudhën e tij në Kolegjin Ilirik të Fermo-s shih DEMIRAJ 2013 29vv.

52 ARSI Rom 229 22r.

1723 në praninë e Gjon P. Nikollë Kazazit.⁵³ Më tej s'mësojmë gjë se informacioni ndërpritet deri në vitin 1729.

59. <Lazarus Wladagni> (= /Lazër Vlladanji/): prej Dioqezës së Shkodrës. Informacionin e parë për të e kemi në regjistrin e vitit 1723, kur sapo kishte filluar të studionte në vitin e parë lëndën e gramatikës në moshën 16 vjeç [35 674r], të dytin dhe të fundit në regjistrin e vitit 1730, kur studionte teologji në moshën 22 vjeç. Betimin e kreu më 11 tetor 1723.⁵⁴
60. <Stephanus Melgusci> (= /Shtjefën Melgushi/): prej Dioqezës së Sapës me vendin e caktuar në bursën për Këtej-Drinit; pas gjase ka hyrë në kolegji në vitin 1727 në moshën 14 vjeç, meqë informacionin e parë e kemi prej regjistrit të vitit 1730, kur studionte gramatikë në vitin e tretë në moshën 17 vjeç. Vërejmë të jetë i regjistruar në lëndën e gramatikës edhe në vitet 1732-1733 [35 758r; 788r]. Betimin rezulton ta ketë kryer më dt. 25 janar 1728.⁵⁵ Më shumë nuk mësojmë dot më ndaj këtij emri; në rastin më fatlum duhet të jetë kthyer në dioqezën e vet si rishtar i paprerë për punë shkolle.
61. <Matheus Borri>: prej Gjakove e me vendin e caktuar për Dioqezën Bosnjës. Informacioni i dhënë nuk lejon patjetër identifikimin e vendlindjes së tij me toponimin e Gjakovës në Rrafshin e Dukagjinit. Hyri në kolegji pas gjase në vitin 1728 në moshën 17 vjeç dhe studioi aty deri në vitin 1637, në moshën 26 vjeç.
62. <Nicolaus Pezzi> (?): Këtë emër e ndeshim vetëm në librin e betimeve (ARSI Rom 229 22v) që të ketë kryer betimin më dt. 28 shtator 1728 (: <28 7bris 1728>) në praninë e Lazër Vlladanjit dhe të Pal Kampsit si dëshmitarë okularë.⁵⁶ Një tjetër rishtar me këtë emër na shfaqet shumë mote më vonë në regjistrin e kolegjit (shih nr. 92). Edhe ky një tjetër rast, kur e kemi të vështirë të japim një zgjidhje konkrete.
63. <Georgius Wladagni> (= /Gjergj Vlladanji/): prej Shkodre. Hyri në kolegji me bursën "Vlladanji", pas gjase në vitin 1729, në moshën 17 vjeç. Vitin e dytë deri atë të katërt (1730-1732) vijoi të studionte ende gramatikë [35 716r; 758r], vitin e pestë retorikë [1733: 788r], të gjashtin dhe të shtatin filozofi [1734: 791r; 1735: 806r] dhe të tetin e të nëntin teologji skolastike dhe morale [1736: 809r; 1737: 841r].

53 ARSI Rom 229 22r.

54 ARSI Rom 229 22r.

55 ARSI Rom 229 22v.

56 ARSI Rom 229 22v.

64. <Andreas Lumbesci> (= /Ndre Lumbeshi/): prej Zymi pranë Prizrenit. Pas gjase ka hyrë në kolegji në vitin 1729 në moshën 18 vjeç. Katër vitet e para studioi gramatikë [1730: 716v; 1732: 758r], më pas retorikë [1733: 788r]. Më 6 shkurt 1729 ka bërë gjithashtu edhe betimin në praninë e Lazër Vlladanjit dhe të Pal Kampsit.⁵⁷ Pas këtij viti nuk kemi më informacion, meqë mungon emri i tij në listat e nxënësve.
65. <Joannes Peluchi> (= /Gjon Belushi/ ?)⁵⁸: prej Arqipeshkëvisë së Tivarit; pas gjase hyri në kolegji në vitin 1732 në moshën 14 vjeç. Aty studioi gramatikë deri vitin e tretë [1732: 758r; 1733: 788r; 1734: 791r], më pas dy vjet retorikë [1735: 806r; 1736 809r], filozofi [1838: 854r] dhe dy vitet e fundit teologji skolastike e morale [1739: 866r; 1749: 2r].
66. <Nicolaus Angelus Radovani> (= /Nikollë Engjëll Radovani/): prej Shkodre; hyri në kolegji në vitin 1733 në moshën 19 vjeç dhe studioi aty tre vitet e para gramatikë [1733: 788r; 1734: 791r; 1735 806r], më pas retorikë dhe në vitet 1737-1738 filozofi [35 841r; 854r].
67. <Lazarus Canci> (= /Llazër Kançi/) prej Shkodre e me vendin e parashikuar për Arqipeshkëvinë e Shkupit; rishtar në moshën 16 vjeç, i cili sapo kishte futur këmbët në kolegji, kur hidhet në letër lista e nxënësve të kolegjit për vitin 1735. Filloi siç pritej me lëndën e gramatikës [806r], me të cilën vijoi edhe dy vjet të tjerë [1736: 809r; 1737: 841r]; Emri i tij është i regjistruar edhe për vitin 1738 por pa të dhëna të mëtejshme [854r]. Në vitin 1739 rezulton të jetë në vitin e katërt të kolegjit, ku studion shkencat humane. [866r] E ndeshim më pas edhe në dy vitet që ndjekin, kur studion filozofi [1740: 2r; 1741 14r] e menjëherë pas saj teologji [1742: 35r]. Meqë në dosjen e përmendur më lart (shën. 41) mungojnë listat e viteve 1743 dhe 1744, e kemi të vështirë të fiksojmë datën e mbylljes së studimeve në kolegji prej tij, në mos i kanë dhënë edhe këtij duart për në atdhe.
68. <Stephanus Prendagni> (= /Shtjefën Prendaj/): prej Shkodre, në moshën 16 vjeç e me bursë të caktuar për dioqezat e Tej-Drinit. Sikurse bashkatdhetari i vet Lazër Kançi paraqitet në kolegji në vitin 1735 ku studion gramatikë deri në vitin 1738 [35 806r; 809r; 841r; 854r]. Në vitin 1739 studion lëndët humane [35 866r] e dy vite më pas filozofi [1740: 2r; 1741: 14r]. Sikurse vëllamin e vet Llazër Kançin edhe Shtjefnin tonë e ndeshim për herë të fundit në regjistrin e vitit 1742, kur ka filluar të studiojë filozofi.

57 ARSI Rom 229 23r.

58 Shih më lart nr. 49.

69. <Stephanus Remani> (= /Shtjefën Ermaji/): prej Shkodre në moshën 18 vjeç, kur fillon të studiojë gramatikë në kolegji në vitin 1738 [35 866r], më pas retorikë në vitet 1741 dhe 1742, për të na u rishfaqur rishtas në regjistrat e viteve 1745 dhe 1746, kur studion teologji [36 38r; 51r]
70. <Simone Vladagni> (= /Simon Vlladani/): prej Shkodre; hyn në kolegji në moshën 15 vjeç në vitin 1739, ku fillon siç pritet të studiojë gramatikë [35 866r]. Me këtë lëndë vazhdon edhe në vitet shkollorë 1740 deri 1742 [36 2r; 14r; 35r], për të vijuar më pas me retorikë, sindëkur e ndeshim në regjistrin e vitit 1745 [36 38r]. Pas vitit 1746, kur studion filozofi në vitin e parë [36 51r] humbet përfundimisht kontakti dokumentar me të.
71. <Petrus Beriscia> (= /Pjetër Berisha/) prej Gjakove, që paska marrë vendin vakant të Ipeshkvisë së Nona-s. Një tjetër dëshmi kjo, që i shkon tamam pershtat vendimeve të marra nga Kongregacioni i Shenjtë lidhur me vendet që mbeten vakante në dioqezat ilirike e që duhet të zihen me sosh të prapatokes katolike në Ballkan. Pjetri hyn në kolegji në vitin 1739 në moshën 18 vjeç, por pas studimit të lëndëve të gramatikës për katër vjet me radhë [35 866r; 36 2r; 14r; 35r] nuk e ndeshim më emrin e tij në regjistrat e mëvonshëm, ku gjithsesi informacioni për vitet 1743-1744 mungon. Diçka ka ndodhur: në rastin më fatlum e kanë kthyer me lang e me plang në vendlindje si të paaftë për ato punë.
72. <Dominicus Pisren/Prisen>⁵⁹: prej <Patria/Dioeces. (?): Prisrensis>⁶⁰; merr në kolegji vendin e caktuar për Dioqezën e Samandria-s. E kemi të vështirë të konkludojmë me siguri sa i përket përkatësisë së bashkësisë etnike dhe vendit të origjinës së personit në fjalë, meqë kemi edhe lëkundje në regjistrimin e mbiemrit. Domeniku ynë ka hyrë në kolegji pas gjase në vitin (që mungon) 1747 në moshën 12 vjeç. E ndeshim në regjistrin e vitit 1748, kur studion në vitin e dytë gramatikë [36 59v] e të njëjtën gjë bën deri në vitin 1751 [36 71v; 75r; 79r], për të vijuar më pas dy vjet me radhë në filozofi e dy të tjerë në teologji skolastike dhe morale [1752-1755: 36 83r; 87; 93r; 98r]
73. <Ambrosius Basci/Boschi/Bosco> prej Shkupi. Parregullsitë në regjistrimin e mbiemrit nuk japin dorë për hetime më të detajuara,

59 Viti 1747 duhet të ketë qenë pikë kthese në rritjen e numrit të rishtarëve shqiptarë. Si arsye reale lejohemi të përsiasim mbylljen e Kolegjit Ilirik të Feros më 1746. (shih Demiraj 2015)

60 Zefi (2000 54) identifikon këtu mbiemrin /Bytyqi/ (?).

sidomos sa i përket originës familjare. Duhet të ketë hyrë në kolegji në vitin 1747 në moshën 13 vjeç. E ndeshim për herë të parë në regjistrin e vitit 1748 kur studion gramatikë në vitin e dytë [36 59v], të cilën do ta vijojë deri në vitin 1751 [36 71v; 75r; 79r], për të vazhduar më pas për katër vjet filozofi dhe teologji skolastike e morale [1752-1755; 36 83r; 87r; 93r; 98r]

74. <Philippus Calamasci> (= /Filip Kallamashi/): prej Shkodre, i cili duhet të ketë hyrë gjithashtu në kolegji në vitin 1747 në moshën 13 vjeç. Studion gramatikë deri në vitin 1751 [36 59v; 71v; 75r; 79r] për të vijuar më pas njëri-pas-tjetrit me nga dy vjet lëndët e filozofisë dhe syresh të teologjisë skolastike e morale [1752-1755: 3683r; 87r; 93r; 98r]
75. <Michael Chersegna> (= /Mëhill Kërshenja/) prej Dioqezës së Sapës, duke marrë bursën e caktuar për Këtej-Drinit; hyn në kolegji në vitin 1748 në moshën 18 vjeç e pasi kryen dy vjet përgatitorë [36 60r; 72r] vijon në vitet 1750-1751 të studiojë gramatikë [36 75v; 79v] duke përfunduar studimet e rregullta në vitin 1755 pasi ka mbyllur me sukses edhe lëndët e filozofisë e të teologjisë skolastike e morale. [36 83v; 87r; 93r; 98r]
76. <Jacobus Wladagni> (= /Jak Vlladanji/): prej Dioqezës së Shkodrës; hyn në kolegji me bursën “Vlladanji” në vitin 1748 në moshën 15 vjeç, kur fillon me vitin përgatitor [36 60v], duke vijuar më pas të studiojë gramatikë [1749-1751: 36 71r; 75r; 79v] dhe të mbyllë studimet e rregullta për katër vjet të tjerë në formimin filozofik e teologjik. [1752-1755: 36 83r; 87r; 93r; 98r]
77. <Lazarus Wladagni> (= /Lazër Vlladanji/): prej Dioqezës së Shkodrës e me bursë që i takonte Arqipeshkëvisë së Tivarit. Hyn në Kolegji në vitin 1752 në moshën 20 vjeç, moshë kjo paksa e shtyrë në përqasje me sivëllezërit e vet. Andaj i mjafton pas gjase të studiojë vetëm një vit gramatikë [36 84r] e dy vjet shkenca humane [1753-1754: 36 87v; 93v], duke vijuar më pas si nxënës i rregullt në studimin e filozofisë dhe të teologjisë skolastike e morale. [1755-1758: 36 98v; 102r; 105r; 107r]
78. <Michael Messi> (= /Mëhill Mesi/) prej Dioqezës së Sapës e më bursë të Këtej-Drinit. Hyn në kolegji në vitin 1756 në moshën 18 vjeç, duke vijuar studimet e rregullta deri në vitin 1761 në gramatikë, filozofi dhe teologji skolastike e morale. [36 102v; 105v; 107v; 111r; 144r; 146r]
79. <Angelus Campsi> (= /Engjëll Kampsi/) prej Dioqezës së Shkodrës

- e <occupat locum Macarensem> (?). Hyn në kolegji në vitin 1756 në moshën 13 vjeç, ku pas vitit përgatitor dhe studimit të gramatikës (1757-1758) studion në shkencat humane dhe letërsi (1759-1760) për të vijuar më pas për katër vjet (1761-1764) studimet e rregullta në filozofi dhe teologji skolastike e morale. [36 102v; 105v; 107v; 111r; 144r; 146r; 155r; 185r; 193r]
80. <Petrus Sogagni> (= /Pjetër Zogaj/): prej Gjakove me bursën që i takonte Arqipeshkëvisë së Shkupit. Hyn në Kolegj në vitin 1756 në moshën 16 vjeç ku pas vitit përgatitor studion edhe tre vjet gramatikë (1757-1759). Nuk duket të ketë vijuar deri në fund studimet, pasi nuk e ndeshim më të regjistruar në vitet e mëvonshme. Arsyet s'i mësojmë dot. [36 102v; 105v; 107v; 111r]
81. <Andreas Battucci> (= /Ndre Bytyçi/): prej Gjakove, duke fituar bursën që i takonte Dioqezës së Samandria-s. Hyn në Kolegj në vitin 1756 në moshën 16 vjeç, ku pas vitit përgatitor studion për katër vjet gramatikë (1757-1760) dhe një vit në lëndën e filologjisë (1761). Nuk duket të ketë vijuar deri në fund studimet, pasi nuk e ndeshim më të regjistruar në vitet e mëvonshme. Arsyet s'i njohim dot. [36 102v; 105v; 107v; 111r; 144r; 146r]
82. <Joseph Labun> (= /Zef Labuni/): prej <(Patria) Asumensis/Asurensis> (Zymi/Sumbi ?) në moshën 17 vjeç. Hyn në kolegji më 9 dhjetor 1759, duke zënë vendin e caktuar për Arqipeshkëvinë e Shkupit. Vështirësitë në identifikimin e vendlindjes shpresojmë t'i kemi zgjidhur deri diku pozitivisht në regjistrin e vitit 1766, në të vetmin ku vendlindja e tij identifikohet me <Jacovensis> (= /Gjakova/) çka jep dorë për hetime më të detajuara, sidomos sa i përket origjinës familjare. Zefi ynë kryen studimet e rregullta për tetë vjet, deri në vitin 1767, kur përfundon edhe vitin e dytë në teologji skolastike dhe morale. [36 144r; 146r; 155v; 185v; 193v; 220r; 222r; 228r]
83. <Jacobus Sacci/Saccio> (= /Jak Saçi/) prej Dioqezës së Sapës; ishte 17 vjeç kur hyri në kolegji më 09.12.1761 (: <A die 9 Xbrie 1761>) e studioi aty dhjetë vjet me radhë deri më 1770, duke marrë formim të plotë në fushat e gramatikës, retorikës, shkencave humane, filozofisë dhe të teologjisë [36 155v; 185v; 193r; 220r; 222r; 228r; 246r; 269r; 275r; 283r]
84. <Antonius Saldia> (= /Ndue Sheldia/) prej Dioqezës së Shkodrës. E ndeshim për herë të parë në regjistrin e vitit 1764, ku përpos moshës 11 vjeç nuk mungon as shënimi i pranimit: <A die 17. Xbrij 1763> (= 17.12.1763), duke saktësuar gjithashtu <Studet

rudimentij grammaticae>. Prej regjistrit të vitit 1766 vërejmë se të gjitha këto të dhëna i takojnë Ndue Dodmasit (= <Antonio Dodmassei/Dodmasci> – sic! ?), në proporcion të drejtë me moshën dhe programin mësimor përkatës, çka na lejon të mëtojmë se kemi të bëjmë në këtë rast me të njëjtin person. Kemi të bëjmë edhe me rishtarin shqiptar në moshën më të njomë që kemi ndeshur në kërkimet tona arkivore. Ndoi ynë është gjithashtu studenti me moshën më të re që përfundon studimet e rregullta në kolegji: bash në moshën 21 vjeçare më 1773 kur e ndeshim të regjistruar në vitin e dytë – pra të fundit ! – në lëndët e teologjisë skolastike e morale [36 185v; 193v; 220r; 222r; 228r; 246r; 269r; 275r; 283r; 309r; 326r]

85. <Paulus Campsi> (= /Pal Kampsi/) prej Dioqezës së Shkodrës. Hyn në kolegji në moshën 15 vjeç, duke u paraqitur aty <a die 18 Julij 1764>. E ndeshim të regjistruar rregullisht çdo vit, duke përfshirë edhe regjistrin e vitit 1773, si viti i dytë (pas gjase dhe i fundit) i studimit të teologjisë skolastike dhe morale. Pasiguri në kumtin informativ shkaktonte mungesa e regjistrit të vitit 1774 në fondet e ASPF. [36 220v; 222r; 228r; 246r; 269r; 275r; 283r; 309r; 326r]
86. <Simeon Prendagni> (= /Simon Prendaj/) prej Kazenë në Dioqezën e Shkodrës. U dorëzua në kolegji më 24 mars 1765 në moshën 16 vjeç. Zhvilloi studimet e rregullta të paktën për tetë vjet, duke i mbyllur pas gjase në vitin akademik 1773, kur studionte në vitin e dytë teologji skolastike dhe morale. Pasiguri në kumtin informativ shkaktonte mungesa e regjistrit të vitit 1774 në fondet e ASPF. [36 222r; 228r; 246r; 269r; 275r; 283r; 309r; 326r]
87. <Michael W/Vladagni> (= /Mëhill Vlladanji/) prej Dioqezës së Shkodrës. Hyn në Kolegji më 19 gusht 1765 në moshën 13 vjeç, falë bursës “Vlladanji”. Kryen studimet e plota në kolegji në fushat e gramatikës (1765-1768), të shkencave humane (1769), retorikës (1770-1771), filozofisë (1772-1773) dhe të teologjisë (1774-1775). Vitin 1774 e konsiderojmë si të mirëqenë, edhe pse nuk kemi dëshmi për listat e nxënësve të kolegjit atë vit. [36 222v; 228r; 246r; 269r; 275r; 283r; 309r; 326r; 340r]
88. <Angelo Summa> (= /Engjëll Suma/) prej Dioqezës së Shkodrës, duke zënë vendin vakant të Arqipeshkëvisë së Shkupit. Regjistrohet në kolegji në tetor të vitit 1768 në moshën 15 vjeç dhe zhvillon studimet e rregullta deri në fund të vitit akademik 1776 [36 269r; 275r; 283r; 309r; 326r; 340r; 372r]
89. <Stephanus Toxi> (= /Shtjefën Toksi/ ?): prej Dioqezës së Sapës.

Shtjefni dorëzohet në kolegji më dt. 7 shtator 1770 dhe do ta ndeshim rregullisht të regjistruar në lëndët e programit mësimor deri në vitin 1779, kur studion në vitin e fundit teologji skolastike dhe morale. [36 283r; 309r; 326r; 340r; 381r, 406r; 415r]

90. <Joseph Albanich> (= /Zef Albaniq/ ?) prej Mitrovicë, duke marrë vendin e (caktuar për misionin e) Gjakovës. Një emër familjar tejet domethënës për zonat kufitare, përkatësisht syresh etnikisht të përziera në hapësirën kompakte shqipfolëse.⁶¹ Shmangiet e zakonshme – me latinizimin/italianizimin diturak – gjatë regjistrimeve në kolegji, e bëjnë të pamundur mbiemrin popullor, sado të zyrtarizuar të familjes: (?) *Arbanasi, Arnautoviq* etj. Zefi ynë regjistrohet në kolegji më 24 qershor 1773. Nuk jemi në dijeni për lëndën që ka studiuar vitin e parë të studimit, meqë na mungon regjistri i vitit 1774. Në vitin 1775 mësojmë të ketë studiuar (në kohë rekord) retorikë, kur ka mbushur ndërkohë moshën 18 vjeç. Pas këtij viti i kalon pas gjase me sukses të gjitha fazat e programit mësimor, duke i përfunduar studimet në moshën 23-vjeçare në vitin 1780, kur është i regjistruar në vitin e dytë të teologjisë skolastike dhe morale. [36 340r; 381r, 406r; 415r; 451r]
91. <Petrus Guracucchi> (= /Pjetër Gurakuqi/) prej Shkodrës e me vendin e caktuar asaj dioqeze. Hyn në kolegji më 18 dhjetor 1773. E hasim për të parën herë në regjistrin e vitit 1775 në moshën plot 20 vjeç, kur studion retorikë. Është sigurisht i pranishëm në regjistrat e pesë viteve me radhë, deri në vitin 1780 kur studion në vitin e dytë të teologjisë skolastike dhe morale. [36 340r; 381r, 406r; 415r; 451r]
92. <Nicolaus Pezzi> (= /Nikollë Peci/) prej Luvrës (? <Livarensis>) në Arqipeshkëvinë e Tivarit. Hyn në kolegji më 3 janar të vitit 1774. E ndeshim vazhdimisht në regjistrat e kolegjit, duke filluar prej vitit 1775, kur ishte në moshën 16 vjeç e deri në vitin 1783, kur kishte mbushur ndërkohë plot 24 vjeç dhe studionte teologji. Prania e tij në vitet 1781 dhe 1782, kur na mungojnë dëshmitë arkivore do vështruar si e mirëqenë, edhe pse disi e pazakonshme, pasi edhe në vitin 1780 rezulton të jetë i regjistruar në fushën e teologjisë. [36 340r; 381r, 406r; 415r; 451r; 505r⁶²] Në fund të regjistrit të vitit të fundit lexojmë shënimin: <Terminano i loro studij in quest' anno Nicolò Pezzi per la Chiesa di Antivari [...]>

61 Për raste të tjera, si p.sh. <Damiano Albanesi> e <Marco Albanese> shih më lart (§. 6.1.) me të dhëna leximi shtesë në pjesën I (§§5.1 dhe 5.1.4)

62 Prej këtij viti shkollor vërehet futja e italishtes si gjuhë administrative.

93. <Joseph Borizzi ~ Giuseppe Boricci> (= /Zef Boriçi/) prej Dioqezës së Shkodrës. Dorëzohet në kolegji më dt. 13 gusht 1776 për të zënë vendin e mbetur plot një vit vakant prej Bursës Vlladanji. Regjistrimi i rregullt bëhet për vitin akademik në vazhdim (1777), ku fiksohet moshë e tij 19-vjeçare. Largohet nga kolegji dhjetë vjet më pas, pasi ka kaluar nëpër të gjitha fazat e programit mësimor, duke u përmbyllur me shugurimin priftëror. [36 340r; 381r, 406r; 415r; 451r; 505r; 552r; 556r] Në fund të regjistrimit të vitit 1785 lexojmë edhe shënimin lidhur me mbarimin e studimeve të Zef Boriçit: <Hoc anno studiorum curriculum perficiunt D. Joseph Borizzi [...]>.
94. <Joseph Battuci> (= /Zef Bytyçi/) prej Zyri (= <Sumbi>) në Arqipeshkvinë e Shkupit. U paraqit në kolegji më 10 korrik 1776 me vendim të Kongregacionit të Shenjtë për të zënë vendin e caktuar për Dioqezën e Samandria-s. Regjistrimi pason për vitin akademik në vazhdim (1777), kur i ka mbushur ndërkohë të 13-at. E ndeshim deri në vitin akademik 1780, kur ka studiuar ndërkohë gramatikë për tri vjet dhe ka filluar lëndën e retorikës. [36 381r, 406r; 415r; 451r] Pas këtij regjistrimi humbasin gjurmët, qoftë edhe për arsye objektive, meqë në dosjen e ASPF mungojnë listat e nxënësve të kolegjit për vitet 1781 dhe 1782. Gjithsesi Zefi ynë pritet të kishte përfunduar studimet e rregullta aty te vitet akademike 1784 – 1785.
95. <Alexander Summa ~ Alessandro Summa> (= /Llesh Suma/) prej Dioqezës së Sapës. U dorëzua në kolegji më dt. 8 tetor 1779 dhe regjistrohët si nxënës i rregullt në vitin akademik 1780 në moshën 18 vjeç. E ndeshim rregullisht deri në listën e studentëve të vitit akademik 1787, ku vihet në fund edhe shënimi që i përfundoi atë vit studimet, duke u larguar për në dioqezë së bashku me Ndue Melgushin. [36 451r; 505r; 552r; 552r; 556r; 563r; 594r]
96. <Antonius Melgussi ~ Antonio Melgusci> (= /Ndue Melgushi/) prej Dioqezës së Shkodrës. Hyri në kolegji qysh më 12 shkurt 1780, por – ngaqë regjistrat e viteve 1781, 1782 mungojnë – e ndeshim për të parën herë të regjistruar në vitin 1783 në moshën 21 vjeç, kur studion retorikë. Kryen studimet e rregullta deri në vitin 1787 dhe largohet për në atdhe së bashku me Llesh Sumën. [36 505r; 552r; 552r; 556r; 563r; 594r]
97. <Mattia Crasnich> (= /Mati Krasniqi/) prej Gjakovës në vendin e caktuar për Dioqezën e Samandria-s. Është paraqitur në kolegji më dt. 12 shkurt 1780. Për mungesë regjistrash në dosjen arkivore e ndeshim të parën herë në listën e nxënësve të vitit 1783, kur studion

- shkencat humane në moshën 19 vjeç. Vazhdon studimet e rregullta duke i përfunduar ato me sukses në vitin akademik 1789 [36 505r; 552r; 552r; 556r; 563r; 594r; 615r]
98. <Georgius Batucci> (= /Gjergj Bytyçi/) prej Dioqezës së Shkodrës, por me vendin e parashikuar për Kishën e Durrësit (= të Këtej-Drinit). Paraqitet në kolegji më dt. 7 shtator 1783 dhe regjistrohet për vitin akademik në vazhdim (1784) në moshën 17 vjeç. E ndeshim edhe një herë të regjistruar në vitin akademik 1785 për të studiuar gramatikë: asgjë më shumë se kaq. [36 556r; 563r]
99. <Jacobus Massarech> (= /Jak Mazreku/) prej Janjeve e më vendin e caktuar për Dioqezën e Samandria-s. U dorëzua në kolegji më 2 gusht 1784. Regjistrohet të parën herë në vitin akademik 1785 në moshën 16 vjeç për të studiuar gramatikë. E ndeshim rregullisht në regjistrat e këtij kolegji deri në vitin 1693, kur studionte në vitin e dytë dhe të fundit teologji skolastike dhe morale. [36 556r; 563r; 594r; 615r; 671r; 673r; 679r]
100. <Marcus Negri> (= /Mark Negri/ prej Dioqezës së Lezhës. Hyri në kolegji bashkë me Jak Mazrekun më 2 gusht 1784 dhe po ashtu i përfunduan studimet së bashku më 1693. [36 556r; 563r; 594r; 615r; 671r; 673r; 679r]
101. <Angelus Radovani> (= /Engjëll Radovani/) prej Dioqezës së Shkodrës. U paraqit në kolegji më 2 gusht 1785 dhe filloi studimet e rregullta në vitin akademik 1786 në moshën 18 vjeç në lëndën e gramatikës. Ka studiuar në kolegji jo më larg se viti 1789, kur është regjistruar në vitin e dytë të lëndës së retorikës. [36 563r; 594r; 615r – viti 1788 mungon]
102. <Georgius Logopagi>: prej Dioqezës së Durrësit. U dorëzua në kolegji më dt. 7 nëntor 1786 dhe u regjistrua më 1787 në lëndën e gramatikës, kur ishte në moshën 13 vjeç. I përfundon studimet plotësisht në vitin akademik 1795 me kursin e dytë të teologjisë skolastike dhe morale. [36 563r; 594r; 615r; 671r; 673r; 679r; 688r; 777r; 792r]
103. <Lazarus Vladagni> (= /Llazër Vlladanji/): ardhur prej Dioqezës së Shkodrës me “Bursën Vlladanji”. Pas gjase në lidhje farefisnie por jo i njëjti me adashët e trajtuar më sipër (: <Lazarus Wladagni> – nr. 59 dhe 77). Ishtë në moshën 16 vjeç kur regjistrohet të parën herë në kolegji pas gjase në vitin 1788, pasi ishte paraqitur në të më 7 korrik 1788. E hasim në regjistrin e vitit 1789 kur mëson ende në bazat elementare të gramatikës latine. Megjithatë studion deri në

vitin 1797, pas gjase si viti i fundit edhe për formimin e tij, meqë e lexojmë të regjistruar në vitin e dytë të teologjisë skolastike dhe morale. [36 615r; 671r; 673r; 688r; 777r; 792r; 808r; 814r]

- 104.<Antonius Negri> (= /Ndue Negri/): prej Dioqezës së Sapës, i paraqitur në kolegji më dt. 7 korrik 1788 dhe i regjistruar në moshën 17 vjeç në vitin e parë më 1789, kur studion bazat elementare të gramatikës. E ndeshim rregullisht në regjistrat e viteve në vazhdim, deri në vitin 1797, kur është në vitin e dytë të studimit teologji skolastike dhe morale. [36 615r; 671r; 673r; 688r; 777r; 792r; 808r; 814r]
- 105.<Lazzarus Ereman/Remani> (= /Lazër Ermaji/) prej Dioqezës së Shkodrës. Paraqitet në kolegji më dt. 12 dhjetor 1789 dhe është 15 vjeç, kur regjistrohet në vitin e parë në lëndën e gramatikës më 1790. E ndeshim rregullisht deri në vitin 1797, kur ka studiuar ndër kohë tre vjet gramatikë, tre vjet retorikë dhe është në vitin e parë të filozofisë. [36 615r; 671r; 673r; 688r; 777r; 792r; 808r; 814r] Në një letër të rektorit D. Carlo Ravenali më 25 gusht 1797 mësojmë të jetë liruar nga kolegji, ndër të tjera se: "Lazzaro Remani, ch'era qui per la Chiesa di Scutari e che dalla S. Cong.ne Loretana è stata licenziato per mancanza di Vocazione allo stato Ecclesiastico, e non buoni di portamenti." [36 831r]
- 106.<Nicolaus Summa> (= /Nikollë Suma/): prej Dioqezës së Shkodrës dhe më vendin e caktuar për Arqipeshkëvinë e Tivarit. Paraqitet në kolegji më 27 prill 1790 dhe, siç pritet, regjistrohet më 1791 në lëndën e gramatikës kur ishte 15 vjeç. Emrin e tij e lexojmë edhe në dy regjistrat ndjekës (1792, 1793), po si nxënës në fushën e gramatikës. Më shumë nuk dimë gjë për të. [36 673r; 679r; 688r]
- 107.<Andreas Gasci> (: /Ndre Gashi/): prej Janjeve dhe më vendin e përcaktuar për Dioqezën e Nona-s. Paraqitet në Kolegji më 10 shtator 1790 dhe fillon studimet në vitin akademik 1791 në moshën 16 vjeç. Rezulton i regjistruar në të gjithë regjistrat deri në vitin 1797, kur ka studiuar në mënyrë të tejzgatur gramatikë dhe retorikë. Pas këtij viti kolegji mbyllet historia e tij në kolegji dhe nuk dimë gjë për fatin e tij. [36 673r; 688r; 777r; 792r; 808r; 814r] (§ 5.2)
- 108.<Antonius Bianchi> (: /Ndue Bardhi/): prej Dioqezës së Lezhës. Hyn në kolegji më 29 korrik 1793 dhe regjistrohet më 1794 në moshën 17 vjeç, kur studion tre vjet gramatikë dhe regjistrohet më 1797 në lëndën e retorikës, kur kolegji praktikisht mbyllet me hyrjen e trupave franceze të Napoleonit në Loreto. [36 777r; 792r; 808r; 814r] (§ 5.2)

- 109.<Johannes Logorezzi> (: /Gjon Logoreci/): prej Dioqezës së Shkodrës e me vendin e caktuar për Dioqezën e Budva-s. Hyn në kolegji më 15 gusht 1793 dhe përjeton të njëjtin fat sikurse sivëllai i tij Ndue Bardhi (shih më lart, nr. 108)
- 110.<Antonius Negri> (: /Ndue Negri/): prej Dioqezës së Sapës. Hyn në kolegji më 20 gusht 1795; në moshën 16 vjeç regjistrohet aty për vitet 1796 dhe 1797, kur kolegji mbyllet me hyrjen e trupave franceze në Loreto. Fati i mëtejshëm s'njihet. [36 808r; 814r]
- 111.<Thomas Sogagni> (: /Tomë Zogaj/): prej Janjevës në Arqipeshkëvinë e Shkupit. Hyn të njëjtën ditë, është në të njëjtën moshë dhe pëson të njëjtin fat sikurse bashkërishtari i vet Ndue Negri. (nr. 110)
- 112.<Johannes Baptista Doda> (: /Gjon Pagëzuesi Doda/): prej Arqipeshkëvisë së Durrësit. Është ndër rishtarët e fundit që hyn në kolegji (27 gusht 1796) dhe regjistrohet si i tillë më 1797, viti kur kolegji i mbyll siparet e vet më shumë se dyshekullorë. Për fatin e tij nuk mësojmë gjë më shumë se kaq.
- 113.<Pietro Ginagni> (= /Pjetër Gjinaj/): prej Ipeshkëvisë së Shkodrës është për çdo rast rishtari më i pafat, meqë s'arriti të gëzojë asnjë ditë arsimimi në kolegji. E mësojmë këtë në njërën ndër letrat të fundit e po aq të ndjeshme të rektorit të fundshekullit në atë kolegji, Don Carlo Ravenali-t më 23 gusht 1797 (shih Pjesa I: § 5.2)

6.3. Faza III: vitet 1834 – 1860

Siç u vu në dukje në tekstin e rrjedhshëm (Pjesa I: § 5.3.), kjo fazë me jetëgjatësi modeste fillon pas një ndërprejeje prej plot 36 vjetësh, e cila u shkaktua fillimisht me hyrjen e trupave franceze të Napoleonit më 1797/8 në Loreto, por u zgjat disi për shkak të punimeve restauruese që duheshin ndërmarrë në ndërtesën ekzistuese të Kolegjit Ilirik. Pas gjase ishte kjo zvarritje që nxiti Kapitolin e Shtëpisë së Shenjtë të mbështesë çdo vit gjatë periudhës 1822-1833 katër rishtarë ilirikë me bursa studimi, duke i dërguar ata në Kolegjin Urban në Romë e duke mëkëmbur me këtë rast zulumën e dikurshme të Kolegjit Ilirik të Loretos.

Hetimi i plotë i emrave dhe i origjinës së këtyre rishtarëve paraqet gjithsesi vështirësi inkuadrimi në historinë e kolegjit tonë ilirik, përkatësisht në radiusin e rihapjes së tij në vitin 1834. E kjo për një arsye të thjeshtë: nuk u bartën në të si dikur as ata rishtarë ilirikë që studionin ndërkohë e pas këtij viti në Kolegjin Urban. Këtë e mësojmë ndër të tjera në një informacion plotësues: “Nota degli alunni Illirici dimorati da Luglio,

a tutto Decem. 1839 nel Vener. Collegio Urbano de Prop. Fide”,⁶³ ku kemi të regjistruar mbiemrat e një numri rishtarësh “ilirikë” me origjinën përkatëse, ndër të cilët edhe këta nëntë nxënës pas gjase shqiptarë den-baba-den:

<Spattari>	Albanese
<Bubbi>	“
<Summa>	“
<Suggi>	“
<Radovani>	“
<Beriscia>	“
<Tacci>	“
<Galata>	“
<Murrichi>	“

Sa i përket pjesëmarrjes së elementit shqiptar gjatë fazës së tretë në Loreto vështirësitë në hetim lidhen me mungesën e theksuar të regjistrave vjetorë. Kështu p.sh., kërkimet tona në Loreto (ASSC) nuk patën fare sukses në këtë drejtim, ndërsa për ato në Romë (ASPF SC Collegi vari vol. 36 – Anni: 1821-1883) u shpërblyem thjesht dhe vetëm me gjetjen dhe hetimin e gjithë-gjithë e pesë regjistrave, bash për vitet mësimore: 1846, 1851 (2), 1855, 1858, 1859.

Në këta regjistra kemi mundur të identifikojmë plot 11 rishtarë shqiptarë, si vijon:

114. <Lorenzo Ascicu> (= /Lorenz Ashiku/): lindur më 21 shtator 1823 në Shkodër. U dorëzua në kolegji më 29.03.1838. Në regjistrin e vitit 1846 rezulton të ketë studiuar teologji në vitin e dytë me rezultatin <mediocre> në impenjim dhe përfitim. [36 882r]

115. <Giovanni/Joannes Negri> (= /Gjon Negri/): lindur, më 31 dhjetor 1831 në Kallmet⁶⁴ të Dioqezës së Lezhës. Në kolegji hyri më 29 mars 1845 dhe në regjistrin e vitit 1846 rezulton të ketë studiuar gramatikë në nivelin e dytë me rezultatin <mediocre> në impenjim dhe përfitim. [36 882r] Në regjistrat e vitit 1851 mësojmë të ketë përfunduar me rezultate shumë të mira fushën e filozofisë në të dyja

63 ASPF: SC Collegi vari, 36 869r. Këtë listë e shoqëron një shkresë e shkurtër e rektorit L. X. Figari S.J. më 31.12.1639, i cili ndër të tjera thekson: “Dal sudetto Certificato risulta, che non solo il Ven[erabile] Collegio Urbano ha adempito alla Convenzione stabilita colla Congregazione Lauretana p[er] il mantenimento di fr:° 4 Giovani illirici, ma eziandio ne ha mantenuto [??] di più, per cui a seconda della sudetta Convenzione va creditrice la Sag. Congr. De Prop. Fide per d’opera di un semestre, da luglio, all Dec. Con della Somma di scudi duecento [??] dalla Propaganda. | Li 31. Decem. 1839”

64 në regjistrin e vitit 1846 shënohet vendlindja gabimisht <Celmento in Albania>, ndërsa në të tjerët rregullisht <Calmetti, Dio. Alexiensis>. E dyshimtë është edhe data e lindjes, e cila në tre regjistra të tjerë shënohet <27 Xbris 1831> (= 27.12.1831).

nivelet. [36 895r; 899r] Në regjistrin e muajit korrik 1855 mësojmë të ketë përfunduar shkëlqyeshëm kursin e teologjisë dogmatike dhe morale në nivelin e trete dhe se së shpejti do të shugurohet prift: “Diaconus, et in proximo 7bri sacerdos consacrabitur.” [36 916r]

116. <Angelo Radoja> (= /Engjëll Radoja/): lindur më 10 shkurt 1828 në Shkodër. Në kolegji ka hyrë më 14 shtator 1841.⁶⁵ Në vitin mësimor 1846 studioi me rezultate të mira filozofi në nivelin e parë. [36 882r] Viti mësimor 1851 është i fundit për të kur përfundon me sukses lëndët e teologjisë dogmatike dhe morale dhe shugurohet prift më 20 shtator 1851 [36 895r; 899r]
117. <Giovanni Busciati> (= /Gjon Bushati/): lindur më 4 janar 1823 në Shkodër. Në kolegji hyri më 29 mars 1838 dhe në vitin mësimor 1846 studioi retorikë, por nuk arriti ta mbaronte, meqë u nda nga jeta pas një sëmundjeje të rëndë. [36 882r]
118. <Agostino Chicci> (= /Agustin Kici/): lindur më 18 shtator 1824 në Shkodër. Në kolegji hyri më dt. 14.11.1841 dhe në vitin mësimor 1846 studioi shkencat humane, po jo me suksesin e dëshiruar dhe shëndetlig, andaj u kthye në vendlindje në qershor të po atij viti. [36 882r]
119. <Joannes Gazzoli> (= /Gjon Gazulli/ ?): lindur më 5 janar 1827 në Dajç në Dioqezën e Lezhës. Hyri në kolegji më 21 tetor 1846. Në regjistrat e vitit 1851 mësojmë të ketë studiuar teologji dhe filozofi në nivelin e parë e me rezultate të shkëlqyera. [36 895r; 899r] Në foljet e mëpasme që i takojnë pas gjase vitit mësimor 1852, mësojmë për Gazullin të jetë shuguruar prift e që pret të kthehet në atdhe.⁶⁶
120. <Antonius Melgusci> (= /Ndue Melgushi/): lindur më 16 janar 1833 në Kashnjet të Dioqezës së Lezhës. Hyri në kolegji më 25 tetor 1850 dhe në regjistrat e vitit 1851 rezulton të ketë përfunduar lëndën e gramatikës në dy nivelet e parashikuar. Në nivelin e dytë bien rezultatet në studim, përfitim dhe sjellje, duke u vlerësuar me notën <mediocres>. [36 895r; 899r]
121. <Pascalis Junchi> (= /Paskal Junku/): lindur në Shkodër më 1 prill

65 Në regjistrat e vitit 1851 jepet gabim ditëlindja (24.02.1828) dhe hyrja në kolegji (21.09.1841).

66 “Eminentissime Principe | Il Sacerdote Giovanni Gazzoli Alunno del Collegio Illirico in Loreto Oratore U.mo dell E.V.a col dovuto ossequio espone, che dovendo nella prossima ventura Primavera ritornare alla sua Diocesi di Sappa in Albania supplica umilmente la benignità di V. Em.ma a volersi in tempore presso l'Ambasciatore Austriaco onde ottenere il beneficio del trasporto gratuito sul Vapore da Ancona sino ad Antivari che della grazia ecc.” [35 905r]

1838 dhe në kolegji hyn më dt. 24 maj 1853. Në regjistrin e vitit mësimor 1855 mësojmë të studiojë shkenca humane dhe në vitin 1858 “Linguarum peritia: Patriae et italiane studet” me rezultate të shkëlqyera. [36 916r; 926r]

122.<Petrus Lusci> (= /Pjetër Lushi/): lindur në Lezhë më 1 qershor 1839. Hyri në kolegji më dt. 25 prill 1855, ku studion fillimisht bazat e gramatikës [36 916r] ndërsa në vitin mësimor 1858 gjuhë dhe kulturë italiane me rezultate shumë të mira. [36 926r]

123.<Alexander Bianchi> (= /Sandër Bardhi/): lindur në Mërqinjë të Dioqezës së Lezhës më 1 shtator 1843. Hyri në kolegji më 22 tetor 1856. Këtë e mësojmë në regjistrin e vitit 1858, ku studion me rezultate “laudabilis” gjuhë dhe kulturë italiane [36 926r]

124.<Georgius Masarec> (= /Gjergj Mazreku/): lindur në Janjevë më 11 shkurt 1839. Në regjistrin e vitit 1858 mësojmë të ketë hyrë në kolegji një vit më parë, shi më 27 maj 1857 dhe studion ende parimet elementare të shkollës. [36 926r]

Katalogu i fundit që mundëm të shfletojmë në ASPF i takon vitit 1859 [36 927r], në të cilin janë të regjistruar katër rishtarë shqiptarë, emrat e të cilëve i përmendëm më lart: Paskal Junku, Pjetër Lushi, Sandër Bardhi dhe Gjergj Mazreku e që dëshmojnë të njëjtat rezultate. Një vit më pas kolegji mbyll përfundimisht këtë shekull siparet e tij, për t’i rihapur mjerueshëm në vitin 1925, por pa kurrfarë rëndësie për ????? dhe aksesit me hapësirën kompakte shqipfolëse.

7. Përfundim

Mbyllim këtu studimin tonë ballor mbi jetën e rishtarëve shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Loreto-s si vatra në mos më e hershme, të paktën ajo më jetëgjatë në formimin e organizuar intelektual-fetar me destinacion ruajtjen dhe mbarështimin e grigjës katolike (edhe) shqiptare sidomos përgjatë shekujve XVII - XVIII; një vatër kjo, që – sikurse më pas e ndërkohë Kolegji Ilirik i Fermos (1663-1746) dhe Kolegji Urban i Vatikanit (1627-) – u përftua falë asaj ndërmarrjeje afatgjatë të Kurisë së Shenjtë me parandaluar rrëgjimin e përsheptuar të nivelit teologjik-intelektual në radhët e klerit vendor, sidomos në ato treva (ballkanike) që kishin rënë ndërkohë nën sundimin osman ose influencoshin drejtpërdrejt prej tij. Nuk ekzagjerojmë aspak, në rast se mëtojmë tash që ishin bash këta rishtarë që sendërtonin atëbotë së bashku elitën intelektuale-fetare të kohës (*alunët* = it. *alluni*), e cila duke pasur si mision kryesor përkujdesjen e grigjës së krishterë brendapërbrenda bashkësisë shqipfolëse, u përkudes në të njëjtën kohë të ruante dhe mbarështonte edhe kulturën shpirtërore,

sikurse edhe atë të shkrimit shqip në këtë bashkësi.

Sigurisht që jo për çdo rast na ndihmoi fati, por të paktën në çdo rast na u shpërblye munda i një pune sa të lodhshme, aq edhe intensive në disa arkiva, sikurse edhe në qëmtimin e të dhënave shtesë në letërsisë ekleziastike dhe enciklopedike të kohës. Produkt i kësaj pune është edhe inventari i plot 124 rishtarëve që u dorëzuan në kolegji në një hapësirë kohore për thuajse tre shekuj, e që shumë syresh arritën të ngjisnin shkallët më të larta të hierarkisë klerikale në Provincën e dikurshme Kishtare të Arbënit, të Kishës Metropolitane të Ohrit dhe të Arqipeshkvisë së Shkupit. Jo pak të tillë kultivuan me vetëdijë edhe kulturën e shkrimit shqip në ato treva, si p.sh. – aq sa kemi mundur të njohim deri sot !!! –: Pjetër Budi, Ndre Bogdani, Frang Bardhi, Gjergj Toliq, Gjon P. Nikollë Kazazi, Gjergj Radovani, Engjëll Radoja.

Për më tepër u përditësuam me copëza të jetës rinore shqiptare në shek. XVI-XIX për 124 të rinj që u përballën sipas mënyrës e natyrës së vet me Thirrjen Hyjnore e jo kalimthi me ndeshtrashat e jetës së përditshme në kolegji, sikurse edhe me rreptësinë e organizuar të formimit fetar-intelektual të kohës (*Ratio studiorum*). Përjetojmë pra *live* copëza të jetës së përditshme në kolegji e fate njerëzore për mbi 120 rinj shqiptarë tipash krejt të ndryshëm: të rregullt, të bindur, të zgjuar, të dashur, të nxënshëm, por edhe shëndetligj e jo më pak syresh çapkënë, zanxarë, tinëzarë e zullumqarë ose thjesht të paprerë për atë të shkretë shkollë, në mos të gatuar së prapthi e kokëshkretë, njëlloj siç i jetojmë e përjetojmë sot e gjithë ditën njerëzit tanë në jetë, pra edhe në kolegjet e seminarët kishtare: as më shumë e as më pak.

Abstract

The Illyrian College in Loreto (1580-1860) was one of those long-lived educational institutions which provided both clerical and intellectual education for the Catholic clergy. Many of its priests were appointed to the Albanian Ecclesiastical Province and to the Shkup Archdiocese, thus spurring the cultivation of written Albanian, which fuels present-day debates on Albanology.

In the first part of his extended study, "A Cultural and Historical Survey", *Shejzat* 3-4, 2016, Prof. Demiraj revolved around the circumstances leading to the foundation of this college and the teaching programmes (*Ratio Studiorum*) of the Jesuit Fathers. In fact, they ran it from 1580 to 1773. Other subtopics in that study were that of everyday life in the

college and further life and deeds of the Albanian seminarians. In the second part of this study the author gives accounts on the lives of 124 seminarians/ priests. Further bibliographical data are also given, spanning 1580-1860.

Bibliografi e cituar në këtë pjesë

1. Burimet

ACU – Archivio del Collegio Urbano (Roma).

AQSH – Arkivi Qendror i Shtetit të Republikës së Shqipërisë (Tiranë)

ARSI – Archivio Romano della Società di Gesù (Roma)

ASPF – Archivio Storico de Propaganda Fide (Roma)

ASSC – Archivio Storico della Sacra Casa (Loreto)

2. Literaturë shkencore

BARTL, Peter - Camaj Martin

1967: Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689, në: "Zeitschrift für Balkanologie" nr. 5, f. 23-33.

Demiraj, Bardhyl

2013: Jeta dhe trashëgimia e Gjon P. Nikollë Kazazit. Shkodër 2013

2015: Jetë rishtarësh shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Femos (1663 - 1746), në : "Hylli i Dritës" nr. 3-4, f. 425-446. Shkodër.

JURIĆ, Josip

1982: Iz arhivske gradje o ilirskom kolegiju u Loretu, pjesa I, në: "Vrela i prinosi" nr. 13, f. 61-105.

JURIĆ, Josip & Korade, Mijo

1983: Iz arhivske gradje o ilirskom kolegiju u Loretu, pjesa II, në: "Vrela i prinosi" nr. 14, f. 155-203.

Zefi, Frok

2000: Arqipeshkvniija Shkup-Prizren në shekullin XVIII-të, Osijek 2000.